

UNIVERSITETI I EJL  
ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ  
SEE UNIVERSITY



FAKULTET I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT  
ФАКУЛТЕТ ЗА ЈАЗИЦИ, КУЛТУРИ И КОМУНИКАЦИЈА  
FACULTY OF LANGUAGES CULTURES AND COMMUNICATION

## **STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË**

**TEMA:**

**“VEÇORIA E KULTURAVE TË VENDEVE BALLKANIKE  
NË KAPACITETIN E TYRE KOHEZIV DHE INTEGRUES”**

**Kandidati:**

**Fjolla Zllatku**

**Mentori:**

**Prof. Dr. Veton Latifi**

**Tetovë, dhjetor 2019**

## Abstrakt

### VEÇORITË E KULTURAVE TË VENDEVE BALLKANIKE NË KAPACITETIN E TYRE KOHEZIV DHE INTEGRUES

Hulumtimi dhe shkrimi mbi Ballkanin paraqet, mbi të gjitha, një ndërlidhje të një korpusi të madh të literaturës, i cili domosdoshmërisht do të vijojë së prodhuari gjithnjë e më shumë material me kalimin e viteve. Gjatë evolucionit të njerëzimit, Ballkani nuk ka qenë vetëm një zonë kalimi mes kontinentesh, por edhe një territor ku njeriu mëson të tejkalojë kundërshtitë *mes perandorive dhe perëndive*. Për më tepër, dallimet kulturore të Ballkanasve nuk kanë qenë kurrë vetëm një çështje mbijetese, por një mundësi për integrimin e tyre në një atdhe më të madh dhe të përbashkët, siç pritet të jetë Bashkimi Evropian.

Synimi i këtij punimi është pikërisht kërkimi i dallimeve kulturore mes popujsh të ndryshëm ballkanikë dhe harmonizimi i tyre, i pasqyruar me anë të shenjave metaforike të urave, udhëkryqeve, si dhe strategjive për të dalë nga izolimi, gjegjësisht nga ai “labirint ballkanik”. Në këtë punim i kushtohet një vend veçanërisht të rëndësishëm perceptimit evropian mbi Ballkanin dhe ballkanasit dhe anasjelltas, si një kusht për të kuptuar ballkanizimin dhe ballkanizmin si mbetje të orientalizmit, si dhe rishqyrtimi i këtyre hipotezave me argumentimet e studimeve të tërthorta mbi temën e Ballkanit nga Marija Todorova në librin e saj *Ballkani Imagjinar*. Këto qasje ndaj temës në fjalë janë të një rëndësie kyç për të kuptuar pozitën e Ballkanit dhe ballkanasve mes etnocentrizmit dhe multikulturalizmit në frymën e teorisë së Samuel Hantingtonit mbi *historinë e re* të vepra e tij e mirënjohur *Përplasja e qytetërimeve*. Një vend të veçantë zë edhe përkufizimi i kulturës nëpërmjet dimensioneve në frymën e teorisë së Geert Hofstede-s e më pas edhe aspektet e politikave kulturore. *Modeli kulturor ballkanik* dhe konvergjenca e ndërsjellë e gjuhëve dhe kulturave i vënë në pah aspektet e jetesës nën prizmin fetar (të myslimanëve dhe të krishterëve), afërsinë e misticizmit ortodoks dhe islamik të Ballkanit.

Këto përpjekje kanë një synim – gjetjen e një vërtetimi të argumentuar të karakteristikave kulturore të popujve si një “*modus vivendi*” i kapaciteteve të tyre integruese në Evropën e bashkuar.

**Fjalë kyçe:** Ballkan, Evropë, kulturë, integrim, ballkanizim, kohezion.

## Abstract

### THE CULTURAL PARTICULARITY OF CULTURES IN BALKAN COUNTRIES IN THEIR COHESIVE AND INTEGRATIVE CAPACITY

Research and writing on the Balkans presents, above all, a link between a large corpus of literature, which will necessarily continue to produce more material over the years. During the evolution of mankind, the Balkans was not just a crossing between continents, but also a territory where one learned to overcome the controversy between the Empires and the gods. Moreover, the Balkans' cultural differences have never been a matter of survival, but an opportunity for their integration into a larger and more common homeland, as the European Union is expected to be.

The aim of this paper is precisely to seek to identify and harmonize cultural differences between different Balkan peoples, manifested through metaphorical bridges, intersections and strategies with the intention to emerge from isolation, namely from the so-called "Balkan labyrinth". This paper devotes a particularly important place to the European perception of the Balkans and the Balkan people and vice versa, as a crucial condition for understanding Balkanization and Balkanism as a remnant of Orientalism, as well as reviewing these hypotheses by means of the arguments introduced in Marija Todorova's detailed study of the Balkans in her work *Imagining the Balkans*. These approaches to the topic in question are of key importance for understanding the position of the Balkans and the Balkan people in the midst of ethnocentrism and multiculturalism, seen through the well-known theory of Samuel Huntington in his *Clash of Civilizations*. A special place is held to explain the definition of culture through the dimensions of Geert Hofstede's cultural theory and furthermore discuss the aspect of cultural policies.

The European and Balkan cultural relations, their common cultural characteristics and the discontinuity issues of Balkan cultures are also considered in depth.

All the above mentioned efforts have a goal, that is to find an argumentized proof of the cultural characteristics of peoples as a Modus Vivendi of their integration capacities in united Europe.

**Key words:** Balkan, Europe, culture, integration, balkanization, cohesion.

## Апстракт

### ПОСЕБНОСТА НА КУЛТУРИТЕ НА БАЛКАНСКИТЕ ЗЕМЈИ ВО НИВНИОТ КОХЕЗИВЕН И ИНТЕГРАТИВЕН КАПАЦИТЕТ

Истражувањето и пишувањето за Балканот претпоставува пред сè надоврзување на енормна литература, која сигурно нема никогаш да престане да се продуцира. Во текот на еволуцијата на човештвото, Балканот не бил само зона на минување меѓу континенти, туку и пространства низ кои луѓето ги надминуваа противречностите меѓу империите и боговите. Културните разлики за Балканците биле не само прашање на опстанок, туку и шанса за нивно интегрирање во поширока заедничка татковина каква што ќе биде Европската Унија.

Целта на овој труд е токму во потрагата на културните разлики на различните балкански народи и нивната хармонизација кои се покажуваат низ метафоричките знаци на мостовите и крстопатите, како и стратегиите на излез од изолацијата, односно „балканскиот лавиринт“. Во трудот битно место зазема европската перцепција на Балканот и Балканците и обратно, која ќе биде предуслов за разбирање на балканизацијата и балканизмот како рецидив на ориентализмот како што вели Марија Тодорова во *Замислувајќи го Балканот*. Овие пристапи се од клучно значење и во духот на теоријата на Самјуел Хантингтон за објаснување на најновата историја преку неговиот труд *Судирот на цивилизациите*. Заслужува посебно место дефиницијата на културата и нејзините димензии во духот на теоријата на Геерт Хофштеде, потоа аспектите на културните политики. Посебно место се посветува на релациите на европските и балканските култури, на нивните заеднички цивилизациски обележја, на прашањата на дисконтинуитетот на балканските култури.

Напорите во трудот авторот ги насочува кон изнаоѓање и аргументирано потврдување на посебните културни обележја на балканските народи како *modus vivendi* на нивните интегративни капацитети во обединета Европа.

**Клучни зборови:** Балкан, Европа, култура, интеграција, балканизација, кохезија.

## PËRMBAJTJA

<b>HYRJE</b> .....	<b>7</b>
<b>KAPITULLI 1</b>	
<b>Harta kulturore e Ballkanit</b> .....	<b>13</b>
<b>1.1</b> Përse „Kultura’’? Ç’është kultura?.....	<b>16</b>
<b>1.2</b> Dimensionet kulturore sipas Geert Hofstede.....	<b>17</b>
<b>1.2.1</b> Distanca e lartë dhe e ulët ndaj pushtetit.....	<b>17</b>
<b>1.2.2</b> Individualizmi kundrejt kolektivizmit.....	<b>17</b>
<b>1.2.3</b> <i>Mashkullariteti</i> kundrejt feminitetit.....	<b>18</b>
<b>1.2.4</b> Shmangia e pasigurisë.....	<b>18</b>
<b>1.2.5</b> Dimensioi afatshkurtër kundrejt orientimit afatgjatë.....	<b>18</b>
<b>1.2.6</b> Inkurajimi i kënaqësisë kundrejt vetëpërmbajtjes.....	<b>19</b>
<b>1.3</b> Kultura politike.....	<b>20</b>
<b>1.3.1</b> Kultura politike si element funksional për demokratizimin e shoqërisë shqiptare.....	<b>22</b>
<b>1.4</b> Elementet e kulturës: kultura materiale, vlerat dhe sjelljes, zakonet, estetika.....	<b>25</b>
<b>1.5</b> Globalizimi kulturor.....	<b>27</b>
<b>1.6</b> Restaurimi i rregullit global liberal.....	<b>29</b>
<b>KAPITULLI 2</b>	
<b>Kultura, integrimet dhe Ballkani</b> .....	<b>31</b>
<b>2.1.</b> Diskontinuiteti në zhvillimin e kulturave ballkanike.....	<b>32</b>
<b>KAPITULLI 3</b>	
<b><i>Modus Vivendi</i> për kohezionin dhe integrimet evropiane</b> .....	<b>34</b>
<b>3.1.</b> <i>Modeli kulturor ballkanik</i> dhe konvergjenca e kulturave ballkanike.....	<b>36</b>
<b>3.2.</b> Aspekte të bashkëjetesës ndër popujt ballkanikë në prizmin e besimeve.....	<b>37</b>
<b>KONKLuzion</b> .....	<b>40</b>
<b>BIBLIOGRAFI</b> .....	<b>44</b>

**“Nëse Ballkani nuk do të ekzistonte, do të ishim detyruar ta shpiknim.”**

*Herman Kejslerling*

**„Njerëzit dhe perënditë takohen dhe shkëmbehen në ura dhe kryqëzime. Në Ballkan, këto dy palë bashkohen me anë të një procesi të ndërlikuar kontaktesh dhe konfliktesh, i cili i veçon ato prej llojeve ideale të doktrinave fetare apo ideologjike. Gjatë evolucionit të qytetërimit njerëzor, Ballkani nuk ka qenë vetëm një zonë kalimi, por një hapësirë ku njerëzit kapërcenin kundërshtitë mes perandorive dhe perëndive. Ky çmim i lartë paguhet nëpërmjet jetëve të një numri të madh gjeneratash dhe nevojitet një rishqyrtim i ideologjive që shfaqen përmes shenjave metaforike të urave dhe kryqëzimeve, si dhe strategjitë që dalin prej tyre.”**

*Tsvetana Georgieva*

**„Riskajimi i gadishullit të madh në kontinentin mëmë do të sjellë ndryshime të ndjeshme për të gjithë. Vetëm atëherë do të mund të thuhet se unaza dalluese në kthetrat e shkabës së rikthyer nuk do të jetë shenjë e ndarjes, por e kujtimit të një brengje.”**

*Ismail Kadare*

**“Ajo që është madhështore te njeriu është fakti se ai është një urë, jo një qëllim.”**

*Fridrih Niçe*

## HYRJE

Cilësimi i Ballkanit si një zonë gjeografike dhe kulturore nuk ka pushuar te jetë temë e diskutueshme. Kanë qenë të shpeshta punimet dhe diskutimet mbi emrat që i janë vënë gadishullit përgjatë historisë, midis tyre ai i Ballkanit tërheq në mënyrë të veçantë vëmendjen nga fakti i ambiguitetit dhe i karakterit të tij emblematic. Etimologjikisht një fjalë turke që do të thotë “mal”, ajo përdoret nga udhëtarët si shënjuese e vargmalit Hameus i gjeografëve të Antikitetit, në Bullgarinë e sotme, relief i cili tashmë nga popullsia sllave që banon aty, quhet *Stara Planina* (Mali i vjetër).

Cilësimi i Ballkanit, që nga ato kohëra si një zonë gjeografike dhe kulturore vazhdon t'i preokupojë historianët, ballkanologët dhe politikologët. Në fund të viteve 1990, historia Marija Todorova i kushtoi një pjesë të madhe të librit të saj *Ballkani imagjinar (Imagining the Balkans)* emrit që do t'i jepej rajonit dhe sfidave politike që do të tërhiqnin pas termit e ndryshëm të përdorur, duke treguar klasifikimet dhe raportet e forcës që nënkuptonin emërtimet, si në rastin kur ato do të visheshin nga vetë popullsitë ballkanike ashtu dhe në rastet kur do të visheshin nga faktorët e jashtëm, në mënyrë të veçantë nga Evropa Perëndimore. (Todorova: 1997: 13)

Interesi kryesor në këtë punim është sfera komplekse e kulturës në strukturimin e identiteteve të popujve ballkanikë, duke filluar prej kohërave më të lashta deri në ditët tona. Ballkani mund të konsiderohet “si një kontinent i vogël në kontinentin e madh të Evropës”. Në kohëra të ndryshme në territorin e Ballkanit kanë sunduar perandoritë kryesore të Evropës, ajo ilire, romake, bizantine dhe osmane, ndërkohë që secila prej tyre krijonte qytetërimin e saj. Pas rënies së çdonjërës nga këto perandori, kanë mbetur dhe janë gërshetuar mbetjet e tyre duke krijuar shtresa të ndryshme kulturore.

Kultura, si një koncept shumë i gjerë dhe i larmishëm, ngërthen në vetvete çelësa interpretimi për identitetin e çdo populli, pasi rrjeti i saj krijohet prej elementeve më të thjeshta si artefaktet primitive e deri te traditat më komplekse, legjendat dhe mitet, këndvështrimi mbi jetën, zhvillimin dhe të ardhmen, ndjenjat patriotike dhe rryma motivuese që bënë një popull të ngecë apo të ecë. Lënda e këtij punimi, pra, është vetë llupa e studimeve kulturore e qendëruar mbi Ballkanin, si toka e vjetër e luftës dhe dëshirës, apo “gjakut dhe mjaltit”, që sipas disa teorive thuhet se është origjina e vetë emrit *Ballkan*.

Duke u rrekur që të paraqesë një lëndë sa më të formësuar dhe të thelluar të kësaj fushe, punimi do të hedh bazamentin nga i cili do të ngrihen hipoteza, disa prej tyre të njohura e disa të reja, në mënyrë që të zbërthejë argumente dhe qëndrime dhe të hedh dritë mbi rëndësinë kulturore, pasurinë shpirtërore, duke ofruar disa alternativa të bazuara në konkluzione për qëndrimin e duhur të së tashmes që populli ballkanik duhet të mbajë për të përballuar stuhitë e kohës së globalizmit, imperializmit mendor, strukturave dominuese fanatike, në mënyrë që të realizojë fatin e vet si një konglomerat i lakmueshëm trashëgimie, por dhe potenciali kulturor.

Me ndryshimin e kohërave përgjatë historisë, në Ballkan u strukturuan identitete të veçanta, themelet e shteteve – kombeve të mëvonshme. Në këtë mënyrë vendet e Ballkanit, relativisht vonë (pas shpërbërjes të dy perandorive kryesore, që kanë lënë gjurmët e tyre, asaj austro-hungareze dhe osmane) formojnë struktura shtetërore, të cilat i përmbajnë elementet e njëres ose tjetër perandori. Baza strukturore e formuar në këtë mënyrë vijon të mbetet nën ndikimin e tendencave pro-evropiane, të cilat lindin si një oazë mes shkretëtirës së një epoke të globalizmit dhe njëkohësisht të anti-informimit, krahas përpjekjeve për një individualizëm, liri dhe vizion më të madh progresi në nivel botëror.

Shpesh herë në punime shkencore dhe teorike përmenden specifikat e popujve ballkanikë, duke thënë se bëhet fjalë për një botë e cila akoma nuk është diferencuar mes perëndimit dhe lindjes, midis traditës dhe modernizmit, Evropës dhe Azisë, heterogjenizmit dhe homogjenizmit, integritetit dhe dezintegritetit, ngjashmërive dhe dallimeve, realizimit dhe ekzotizmit.

Qëllimi i hulumtimit, si fillim është të identifikojë identitetet e veçanta ballkanike, duke ua kushtuar fokusin kryesor pikave që i dallojnë dhe i karakterizojnë për nga aspekti i kapacitetit të tyre *koheziv* dhe *integruës* në realizimin e detyrimeve integruese në struktura më të gjera dhe të fuqishme siç është Bashkimi Evropian, si dhe në integritet e tjera euro-atlantike.

Veç kësaj, me anë të shpjegimit më të hollë të kulturës ballkanike, duke iu referuar disa teorive të mirënjohura të fushës së studimeve ndërkulturore, siç është teoria e *dimensioneve kulturore* të Geert Hofstede, qëllimi tjetër jo më pak i rëndësishëm është të risillen vlerat e përbashkëta ndëretnike në një frymë të elaboruar pozitive, për të portretizuar atë urë mendore që çon nga njëri popull te tjetri, duke krijuar së bashku cohën e thurur që është vetë gadishulli ballkanik. Kjo, duke u bazuar nga punime të shumta me gjurmime krahasuese, të cilat kanë konstatuar se popujt e Ballkanit, përtej dallimeve të mëdha në identitetin e tyre kombëtar dhe etnik, kanë



shumë elemente të përbashkëta kulturore, të rrënjosura thellë në vetëdijen e popujve dhe që mund të gjenden në sfera të ndryshme të përditshmërisë, duke u nisur nga vetë elementet gjuhësore. Një fenomen i tillë është e vështirë të konstatohet në ndonjë vend tjetër të Evropës.

Me anë të gjurmimit të aspekteve mitike në kulturat ballkanike që rezultojnë prej strukturës së veçantë të territorit ballkanik, i cili është i mbyllur në veri, por nga të katër anët e tjera rrethohet prej deteve (kështu, njeriu i Ballkanit është detyruar gjithnjë “të kërkojë rrugëdalje”), ky punim ka për qëllim të shpalosë dinamikën e mitit të shprehur nëpërmjet mendësisë dhe veprimtarisë së njerëzve që kanë jetuar dhe jetojnë në territorin ballkanik. Një shembull i gjallë dhe i qartë ilustrues është miti i *labirintit*, shprehje e ambivalentes dhe pavendosmërisë në nivel mendor. Traditat e tilla si vallet, këngët, (siç ishin këngët polifonike të shqiptarët) dhe zakonet janë kodi që hap horizontin drejt ideve të fshehura dhe burimit të frymëzimit të një populli, andaj edhe këto do të jenë një mjet i rëndësishëm drejt qëllimit për të shfaqur sa më mirë identitetin ballkanik.

E vërteta është se historia e Ballkanit ka njohur shumë vështirësi dhe ndërlikimet e identifikimit të tij si territor politik, kulturor dhe shoqëror janë asgjë më shumë se sa një prodhim i natyrshëm i çdo populli që do t'i duhej të kalonte fat të ngjashëm. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se tendenca për të damkosur Ballkanin si simbol i varfërisë, dekadencës dhe madje egërsisë është e lejueshme dhe duhet të vazhdojë të ushqehet nga bota. Qëllimi i këtij punimi, në thelb, është që të hedhë dritë, nëpërmjet analizës, fakteve dhe vërtetimeve, se Ballkani është shumë më tepër se sa një histori e dhimbshme e pak shekujve të kaluar. Ai është një thesar dijesh, veprash heroike dhe potenciali të pazbuluar që fle në gjirin e asaj që me nomenklaturë kemi etiketuar si kulturë.

Hipoteza kryesore që imponohet gjatë gjurmimeve në këtë punim është se kultura me përbërësit e saj kryesorë, siç janë gjuha, letërsia, muzika, arkitektura, folklori dhe artet, duke qenë e pranishme në historinë e çdo populli të Ballkanit, ka qenë një mbështetje e fortë, madje edhe atëherë kur ka munguar struktura e fortë mbështetëse e shtetit.

Për këtë hipotezë një ndër shembujt që mund të marrim si mbështetje është vetë identiteti i shqiptarëve, të cilët prej kohës të Skënderbeut, deri në 1912, nuk kanë pasur shtet, por *elemente të forta kulturore* që kanë qenë një shtyllë për kohëra të vështira dhe elemente zëvendësuese të shtetit. Në veçanti kontribute të ndërtimit të këtyre vlerave kulturore kanë qenë Rilindasit si Jeronim de Rada, Faik Konica, Sami dhe Naim Frashëri, Vasko Pasha, Fan Noli, Asdreni.

Vlerat me të cilat kanë mbijetuar ballkanasit në kushte të vështira sidomos në kohërat kur këto vise kanë qenë skena të luftërave ballkanike dhe të dy luftërave botërore, të dezintegruara dhe të okupuara prej shteteve të ndryshme, kanë qenë vendimtare për stabilizimin e tyre dhe për depërtimin e tyre me anë të formave të para të integritit, sidomos në Bashkimin Evropian.

Një hipotezë tjetër që lind me rastin e këtij gadishulli është se vlerat kulturore përbëjnë një mundësi objektive për mbërritjen e kapacitetit integruar të nevojshëm sipas kriterëve evropiane. Jetojmë në një kohë të ndryshimeve të thella të paradigmeve në të gjitha sferat e jetës të cilat janë të lidhura në mënyrë direkte me globalizimin dhe me proceset politike botërore, ku nuk mund të marginalizohen dhe aspektet kulturore karakteristike dhe të veçanta të popujve ballkanike. Për vendet ballkanike imponohet si çështje kyç pyetja se si do të tejkalohen periudhat e gjata të errëta dhe se si do të realizohet lidhja me proceset bashkëkohore të zhvillimit.

Mileti (autonomi gjuhësore dhe fetare e popujve të krishterë nën sundimin e Perandorisë Osmane) është bërthama e identiteteve ballkanike dhe bërthama të shumta qëndrojnë në një drejtpeshim fizik dhe shpirtëror përballë njëri-tjetrit. Ashtu siç shekuj më parë Ballkani shkoi bashkarisht drejt katastrofës, në po atë mënyrë sot duhet të drejtohet drejt integritit dhe shpëtimit.

Në shekullin XX, për shkak keqkuptimeve politike tragjike ky drejtpeshim fizik dhe shpirtëror u prish. Përpjekja për të përjetësuar të keqen në Ballkan me anë të doktrinave të reja ekstremiste nacionaliste dhe gjenocideve (si ajo e nxitur nga "reziku i ekspansionit shqiptar") vjen në kundërshtim me frymën qytetëruese evropiane.

Procesi emancipues, që shtyn popujt e Ballkanit drejt njohjes së vetvetes është një element i domosdoshëm për të kapërcyer tendencat degraduese dhe për të hedhur hapa seriozë drejt integritit dhe kohezionit. Popujt ballkanas qëndrojnë përpara portave të Evropës duke u munduar ta kompensojnë kohën e humbur drejt një lloji evropianizimi të Ballkanit. Të njohësh peshën e vetvetes, të çlirohesh nga fantazmat dhe të kuptosh rëndësinë e vërtetë të tendës dhe të tjetrit është çlirimi nga helmi revanshist dhe fillimi i vërtetë i emancipimit.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar respektimit të metodës induktive, nisja prej fenomeneve të veçanta drejt fenomeneve të përgjithshme. Këtë orientim e kanë krijuar vetë nevojat e nxitura nga fenomenet e përbashkëta të kulturave ballkanike por njëkohësisht të ngarkuara me

divergjenca politike. Mirëpo, një situatë e tillë nuk e ka kufizuar kërkimin e përfundimeve të përgjithshme të cilësive të përbashkëta të kulturave të Ballkanit.

Duke marrë parasysh se punimi përmban materie mjaft komplekse dhe interdisiplinare në zgjedhjen e metodologjisë më të përshtatshme, ai do të bazohet në përzgjedhjen e punimeve empirike dhe teorike prej disiplinave si: komunikologjia, kulturologjia, historia, shkencat politike, sociologjia dhe letërsia.

Shfaqje të gjurmimeve më të thella sa u përket këtyre fushave do të pasqyrohen në shembujt e dallimeve dhe të përbashkëtave të gjuhës shqipe dhe maqedonase, ndërkohë që gjurmime empirike nga ngjarjet e përditshme nga jeta kulturore dhe politike janë poashtu një kriter matës i punimeve të kësaj natyre shoqërore.

Duhet nënvizuar gjithashtu se nuk ka teori apo metodologji shkencore që mund të përdoret gjatë meditimit, vrojtimit, hulumtimit, shpikjes ose zbulimit të problemit, substancës apo aparatit që të mos bëhet në bazë të njohjes së vetes, sidomos kur bëhet fjalë për një materie ose paradigmë fluide, siç është Ballkani. Fenomeni ballkanik është gjurmuar dhe gjurmohet akoma edhe në ditët tona, sidomos para dhe gjatë konflikteve ballkanike dhe botërore në kërkim të rrugëve të pajtimit, tolerancës dhe mirëkuptimit.

Jo rastësisht shkencëtarë bashkëkohorë, mendimtarë dhe filozofë me famë botërore kanë studiuar dhe vazhdojnë të zbërthejnë çështjet e Ballkanit (si Pol Valeri, Vacslav Havel, Edgar Moren, Ismail Kadare dhe Adam Mishnik), duke shoshitur çështjet fundamentale të rajonit me gjithë specifikat dhe enigmat e tyre. Sipas tyre ekziston një kontradiktë mes Ballkanit si realitet gjeopolitik dhe një Ballkani mitik, atij *imagjinar*, që është më i fuqishëm dhe imponues, që tejkalon kufijtë e çdo metodologjie.

Rëndësia e këtij punimi qëndron tek besimi se ai mund të jetë një kontribut modest në favor të kuptimit të nevojshëm të rolit të kulturës dhe rrezatimet e saj në botën në të cilën jetojmë. Kultura është ura më e fortë që lidh popujt nëpër kohëra dhe hapësira. Kultura mëson se dallimet për nga identiteti nuk duhet të jenë pengesë në jetesën e përbashkët në planetin tonë, por duhet të jenë forca e përhershme kohezive dhe integruese. Shembujt dhe konkluzionet që mund të nxirren prej këtij punimi janë në favor të një sqarimi se “Ballkanizmi” nuk duhet të jetë apriori kategori

negative por edhe një lloj kuptimi i realitetit me të cilin janë ballafaquar në kohëra të vështira popujt e pjesës juglindore të kontinentit evropian.

Duke marrë parasysh se ne, në Republikën e Maqedonisë së Veriut jetojmë në një shtet multikulturor dhe multietnik, modeli i bashkëjetesës që ofron ky shtet mund të realizohet vetëm me anë të respektimit të këtij realiteti, pra, me anë të respektimit të kulturës si model realiteti dhe bazamenti të fortë i kësaj shoqërie. Ekzistojnë më shumë sfera të rrezatimit të kësaj kulture dhe sa më mirë të harmonizohen dhe të pranohen si realitet i përbashkët, aq më mirë për totalin. Popujt e Ballkanit nuk do të mund t'i realizonin shumë procese me sukses nëse do të ishin ndarë dhe të përçarë në histori. Është e vështirë që proceset historike të shpejtohen ose të ngadalësohen. Ato kanë rrugën e tyre, mirëpo, shoqëria gjithmonë duhet të jetë e përgatitur për befasishtë që mund të sjellë historia. Ky punim ka rolin t'i kujtojë mundësitë e tilla.

Është gjë normale të thuhet sot se Ballkani ka nevojë për Evropën. Mirëpo lind një pyetje tjetër - a ka nevojë dikush për Ballkanin? Një ndër çështjet e domosdoshme për Ballkanasit në perspektivën pozitive të integritetit evropian duhet të jetë pajtimi dhe toleranca midis popujve që kanë qenë në konflikt në të kaluarën. Andaj dhe një pjesë e mirë e punimit është bazuar mbi kërkimin dhe analizën e elementeve të bashkëjetesës së popujve ballkanikë në të kaluarën pesëshekullore të tolerancës ndërjetare, ndërretnike, ndërkulturore, si baraspeshë e dukurive negative që bien si një cohë e hidhur mbi mjaltin ballkanik.

## KAPITULLI 1

### Harta kulturore e Ballkanit

Kur fillojmë dhe flasim për kulturën, hapi i parë drejt një lloj kategorizimi të kushtëzuar nga mendja njerëzore është lindja e stereotipit. Stereotipi mbi Ballkanin pësoi ndryshime sidomos gjatë kohës së luftës. Analiza e raporteve luftarake gjermane dhe austriake prej 1912 deri në 1918, që u bë nga Meçthild Golçevski, tregon se popujt e ndryshëm të Ballkanit, *trajtohen ndryshe*, sepse nuk ka ekzistuar një ide të qartë se çfarë është Ballkani në realitet. Mënyra se si përdorej kjo kategori për t'i përcaktuar karakteristikat e përgjithshme të rajonit (klishtë e mikpritjes, të fshatarëve dhe malësorëve, të njerëzve që jetonin pranë natyrës, për mentalitetin e prapambetur, për mungesën e higjienës, etj), ishte aq e mjegullt dhe e papërcaktuar sa që mund t'u referohej edhe njerëzve jashtë Ballkanit. Kurdo që të përdorej ky term kishte të bënte më tepër me një gjë të papërcaktuar, por njëkohësisht dhe emocionale.

Veç kësaj, Golçevski përdori, krahas emërimeve të tjera të përgjithësuara, mes të cilave më e shpeshta është emërimi “oriental” që lidhej me fëlliqësi, pasivitet, pasiguri, mizogjeni, tendencë ndaj intrigave, mashtrim, oportunizëm, dembelizëm, besëtytni, letargji, mosefikasitet dhe një burokraci të paaftë, edhe termet karakterizuese të ngurtësisë, paaftësisë, jostabilitetit, paparashikueshmërisë. Të dyja kategoritë përdoren si koncepti i kundërt i *Evropës*, e cila në vetvete simbolizon pastërtinë, rregullin, vetëkontrollin, karakterin, ndjeshmërinë ndaj ligjeve, drejtësinë, efikasitetin administrativ, “shkallë më të lartë të zhvillimit kulturor” i cili fisnikëron sjelljen e njeriut. (Golczewski: 1981: 63-67)

Mirëpo, edhe pse ne mund të pajtohemi se termi “ballkanik” ishte mjaft i papërcaktuar për të qenë karakterizues i veçorive specifike të gjithë rajonit, padyshim komponenti emocional drejt të cilit shkrimtarët shkojnë kohë pas kohe, ndoshta në mënyrë intuitive, bazohet në stereotipin tanimë të përvetësuar por akoma të paartikular qartë.

Gjithashtu në atë kohë, kishte zëra më të arsyeshëm, njerëz të cilët përpiqeshin të shihnin arsytet e vërteta të luftës, duke mos qenë madje pjesë e rretheve të zakonshme social-demokrate, siç ishte Çarls Xh. Vopicka, i cili kaloi shtatë vjet (1913-1920) në Romani, Serbi dhe Bullgari si emisar dhe përfaqësues zyrtar i ShBA. Në memoaret e tija të detajuara, megjithëse nganjëherë jo shumë të sakta në lidhje me disa fakte historike përplot optimizëm amerikan, mbetet i fortë në gjykimin e tij: “Lufta botërore vërtetë filloi në Ballkan, por rrënjët e saj janë në zemrat e autokratëve të paskrupullt, ambicia e të cilëve nuk njihete as drejtësi dhe as kufi.” Ai i rrëzon insinuatat se popujt në Ballkan janë problematikë për nga natyra dhe i paraqet si ushtarë të lojës së madhe. (Vopicka:1921: 98)

Në shqyrtimin e kulturës ballkanike nuk mund të mos përmendet dhe Edith Durham, antropologia e Britanisë nga shkrimet e së cilës gjejmë kaq shumë pasuri kulturore, sidomos lidhur me shqiptarët në Ballkan. Kur ajo kishte nisur në rrugën e saj në botën e Ballkanit, kishte hyrë me të gjitha parafytyrimet dhe emocionet me të cilat fëmijët sot futen në muze për të parë dinozaurët. “Asnjë shtet ballkanik nuk është kaq i errët sa që paraqitet. Secili ka veçoritë e mira që nuk dalin në pah për shkak të rrethanave të ndryshme, ndërsa të metat në të shumtat e rasteve janë të meta të rinisë. Mizoritë që kohë pas kohe i shkaktojnë janë një mbetje e zakoneve mesjetare, të cilat dikur shtriheshin në të gjithë Evropën. Kur bëhet fjalë për gadishullin ballkanik shumë “mizori” janë keqpërdorur për qëllime të caktuara politike.”(Durham:1925:90)

Vepra e Durhamit për atë kohë është e një rëndësie të veçantë, pasi ajo paraqet një qasje të rrallë ndaj Ballkanit dhe ballkanasve. Të vetëdijshëm për mendimin që perëndimi ka për ta, një nga të njohurit e saj, me shumë siguri shqiptar, i ka thënë në mënyrë qortuese:

“Ju anglezët mendoni se jeni të qytetëruar dhe se mund të na mësoni diçka. Ndërsa unë ju them se këtu nuk ka njeri që do të kryente krime të tilla si ato që kryen në Londër. Hajdutët tanë janë njerëz të varfër. Puna në fushë mezi u mundëson mbijetesën. Janë mjaftë të paarsimuar, nuk kanë shkuar në shkollë. Plaçkitin për të jetuar dhe rrezikojnë jetën e tyre në këtë mënyrë. Ndërsa hajdutët tuaj shpesh herë janë me arsim të lartë dhe vjedhin, gënjejnë dhe mashtrojnë që të

pasurohen. Ju me vite gëzoni të gjitha avantazhet e arsimit dhe qytetërimit dhe shikoni se çfarë bëni. Kurse ne na quani egërsira sepse vrasim njerëz.” (Durham: 1905: 133) Durhamit i janë dashur 10 vjet që ta kuptonte se Ballkani është tepër kompleks për t’u kuptuar në tërësi.

Durham fitoi vendin e merituar në historiografinë ballkanike falë përshkrimeve cilësore etnografike të jetës fisnore në Shqipërinë e Veriut dhe në Mal të Zi dhe falë vëmendjes që ia kushtoi një prej popujve më pak të njohur të Ballkanit, shqiptarëve. Dashuria e saj ndaj shqiptarëve, që është për t’u respektuar, bëri që ajo të mos jetë kritike në vlerësimet mbi fetë dhe racat, në vend që në mënyrë racionale të analizojë situatën gjeopolitike.

Afërsisht në të njëjtën kohë, Paul Scott Mawrer, autori i librit i cili e krijoi termin “ballkanizëm” ndan të njëjtën hidhësi: “Për një nxënës rënia e Turqisë dhe e Austro-Hungarisë paraqet një goditje serioze. Në vend që të mësojë për dy shtete, tani i duhet të mësojë për 10. (Scott Mawrer: 1921: 24) Termi “ballkanizëm” u krijua pas luftërave ballkanike dhe luftës së parë botërore duke i dhënë Ballkanit një paraqitje negative. Por kjo nuk ndodhi brenda natës, duke pasur parasysh se edhe gjatë luftërave ballkanike, shtypi perëndimor mbeti më tepër ironik se sa shpërfillës.

Vlerësimi i Ballkanit në bazë racore filloi me pranimin e një qëndrimi më të hapur ndaj popujve të nënshtuar deri atëherë dhe një mendim neutral për përzierjen e racave. Kur thoshin “të pafe dhe heretikë” u referoheshin myslimanëve dhe ortodoksëve. Më vonë ky përshkrim neutral i kompleksitetit etnik dhe fetar i Ballkanit, i cili kohë pas kohe emërtohej si vend ku ka *popuj të çuditshëm*, do të nxisë një ndjenjë averzioni dhe papastërtie. Imazhi për Ballkanin e theksoi *dhunën* si veçori kryesore, e cila deri atëherë thjesht nuk kishte dalë në pah. Në historinë e Ballkanit dhuna nuk është ndonjë risi. Evropianët ishin të terrorizuar nga barbarizmat e lindjes.

Në vitin 1928 në Amerikë doli përkthimi i një libri të botuar në Suedi në vitin 1927, prej autorit të librit Marcus Ehrenpreis i cili kishte vizituar Ballkanin, Egjiptin dhe Tokën e Shenjtë në kërkim të shpirtit të lindjes, “shpirtit të Orientit”. Ai flet me përbuzje për bashkudhëtarët e tij të kthyer nga udhëtimi vetëm me pasuri, fotografi dhe fatura të larta të hotelit: “Nuk mund ta shëtisni orientin në këtë mënyrë. Në qoftë se dëshironi të ndjeni të paktën një pjesë të vogël të shpirtit të orientit nuk duhet t’i qaseni si një vendi të huaj, por sikur po ktheheni në shtëpi, sikur po i ktheheni vetvetes. Mos veproni si dikush që sjell qytetërim, por si një nxënës me modesti.(Ehrenpreis: 1929:38)

## 1.1. Përse kultura? Ç'është kultura?

Kultura është shuma e prodhimtarisë dhe krijimit të një populli apo të të gjithë njerëzimit për zhvillimin e tyre shoqëror (duke përfshirë këtu procesin mendor, shpirtëror dhe material). Ajo karakterizohet dhe dallohet për nga karakteri krijues dhe simbolikat e shprehura në forma nga më të ndryshmet. Është e rëndësishme të mos neglizhohet fakti se, kultura është tipar ekskluziv i njeriut, dhe atë që nga fillimi i procesit të tij të qytetërimit. Njeriu fillon të bëhet i tillë, për dallim nga kafshët e tjera, pikërisht sepse koncepton botën në mënyrë simbolike.

Kultura ngërthen në vetvete besimet, sjelljen, mënyrën e perceptimit dhe jetesës në familje apo bashkësi. Gjatë jetës së tyre, njerëzit pa e kuptuar, thithin disa dituri, vlera dhe zakone të grupit të tyre shoqëror, të cilat u duken normale, kurse zakonet e tjera, të huaja u duken madje edhe kërcënuese. Një kulturë e përbashkët ka fuqinë të forcojë lidhjet brenda shoqërisë. Prej saj individët nxjerrin rregulla të përbashkëta sjelljeje.

Çdo kulturë bazohet në tri elemente: konceptet, traditat dhe artefaktet. Me anë të gërshetimit të këtyre gjërave zhvillohet një këndvështrim i caktuar. Vështrimet ndaj botës reflektohen te zakonet, të cilat formohen, si për shkaqe praktike si mbrojtja e shëndetit dhe siguria, rregullat e të ushqyerit dhe prirjet higjienike, e deri te zakonet e caktuara që janë të vendosura në atë mënyrë që të sigurojnë veprime të drejta në mes njerëzve. Kulturën e formojnë edhe objektet të cilat njerëzit i mbajnë, përdorin dhe u japin kuptim në përditshmërinë e tyre.

Mënyra të tjera të shprehjes së kulturës janë besimet, mënyra e komunikimit, zbulimi i trupit, por edhe arti dhe shkenca. Fetë japin zgjidhje për jetën, shpjegime mbi formimin e universit, prejardhjen e njeriut dhe çfarë ndodh pas vdekjes. Gjuha është një tjetër shprehje e kulturës. Gjuha e përbashkët në një masë të mirë shërben për t'i lidhur njerëzit në kuadër të një shoqërie. Mesazhet e përcjella me anët e shenjave dhe simboleve, si flamujt kombëtarë janë poashtu pjesë e rëndësishme e asaj që quajmë kulturë. Thuhet se arti dhe shkenca janë forma më e lartë e kulturës, pasi arti përveçse mund të jetë një përgjigje e rëndomtë e përditshmërisë sonë, ai mund të përfshijë edhe analiza të larta intelektuale të shfaqjeve. Nga ana tjetër, shkenca është një disiplinë teorike dhe praktike që afron njerëzit me më të vërtetën e konceptueshme brenda një kulture.



## **1.2. Dimensionet kulturore sipas Geert Hofstede**

Sipas Geert Hofstede kultura është më shumë një burim i *konfliktit* sesa i *sinergjisë*. Për të kapërcyer ndryshimet, Geert Hofstede filloi një studim të madh në kuadër të organizatës IBM në 56 vende në vitin 1970. Konkluzionet nga studimi i tij na ka dhënë një pasqyrë nga vende dhe kultura të ndryshme, veçanërisht në lidhje me ndërveprimet efikase midis njerëzve të kulturave të ndryshme. Pas më shumë se 1.000 intervistave dhe një sërë këndvështrimesh, u shfaq *Modeli i Dimensioneve Kulturore Hofstede*. Përgjatë studimeve të njëpasnjëshme këto dimensione u identifikuan në plot 76 vende. Çdo vend ka një shkallë nga 1 në 100 për çdo dimension, sa më i lartë të jetë rezultati, aq më shumë dimensionin në fjalë paraqitet si faktor në kulturë.

### **1.2.1. Dimensioani i parë - Distanca e lartë dhe e ulët ndaj pushtetit**

Përkufizimi i distancës ndaj pushtetit brenda dimensioneve kulturore Hofstede i referohet masës së pabarazisë që ekziston dhe pranohet nga njerëzit me dhe pa pushtet. Kjo përfaqëson pabarazinë (e lartë apo të ulët), por në kuptimin e pranimit. Një rezultat i lartë i këtij dimensionit tregon se bëhet fjalë për një distancë të madhe ndaj pushtetit, nga ku mund të nxirret përfundimi se ekziston një pabarazi e madhe në shoqëri (kulturë). Marrëdhëniet e forta hierarkike, tregojnë një nivel të ulët respekti dhe autoriteti, gjë që është dukshëm e pranishme në shumicën e vendeve aziatike.

### **1.2.2. Dimensioani i dytë - Individualizmi kundrejt kolektivizmit**

Përkufizimi i individualizmit brenda dimensioneve kulturore Hofstede i referohet forcës së lidhjeve reciproke ndërmjet individëve brenda një komuniteti të caktuar. Një rezultat i lartë paraqet lidhje "të dobëta" (mungesë të komunikimeve ndërpersonale) dhe nivel të ulët të ndarjes së përgjegjësisë. Individët e vlerësojnë kohën e njerëzve dhe nevojën e tyre për liri, respektin për privatësinë dhe pritjen e shpërblimit për mundin e investuar. Një shoqëri me një rezultat të ulët të këtij dimensionit (me më shumë kolektivizëm) do të kishte një kohezion të fortë grupi, një sasi të madhe të besnikërisë dhe respektit për anëtarët brenda një komuniteti të caktuar. Theksi bie mbi zhvillimin e shkathtësive, mjeshtërive, ekspertizës.

### **1.2.3. Dimensioni i tretë - Mashkullariteti kundrejt feminitetit**

Ky përkufizim brenda dimensioneve kulturore Hofstede i referohet asaj se sa një shoqëri përputhet me vlerat e saj dhe rolet tradicionale mashkullore dhe femërore. Për meshkujt rëndësi ka performanca dhe sukcesi, ndërsa për gratë modestia, ndjeshmëria dhe cilësia e jetës. Në rastet me rezultat të lartë të këtij dimension, burrat janë mashkullorë (të ashpër, të fortë dhe të sigurtë) dhe gratë janë femërore (të nënshtruara, të buta dhe të mira). Në vendet me rezultate të ulëta të këtij dimension, dallimi midis roleve nuk është kaq transparent. Gratë gjithashtu punojnë në profesione të dominuara nga meshkujt, ekziston një nivel më i lartë bashkëpunimi dhe burrat nuk druhen nga shfaqja e ndjeshmërisë dhe butësisë. Përveç kësaj, gratë e fuqishme dhe të suksesshme admirohen dhe respektohen.

### **1.2.4. Dimensioni i katërt – Shmangia e pasigurisë**

Përkufizimi i pasigurisë brenda dimensioneve kulturore Hofstede i referohet shkallës së ankthit që anëtarët e shoqërisë ndjejnë kur përballen me situata të pasigurta dhe të panjohura. Vendet me nivel të lartë shmangin situata të pasigurta përmes kontrollit (rregullave dhe rendit). Ata kërkojnë një të vërtetë kolektive në të cilën shpresat e tyre lidhen me njëfarë sigurie. Njerëzit me vlerësim të ulët të këtij dimensioni gëzojnë, për shembull, ngjarje dhe nisma të reja, duke mbajtur një qëndrim joformal dhe duke pranuar ndryshimin dhe rrezikun.

### **1.2.4. Dimensioni i pestë - Orientimi afatshkurtër kundrejt orientimit afatgjatë**

Ky dimension i referohet këndvështrimit që ka shoqëria ndaj marrjes së iniciativave të reja, duke u bazuar në traditën e saj historike. Vendet me nivel të ulët të këtij dimension bazohen në traditat shekullore dhe e kanë më të vështirë të përqafojnë ndryshimin. Zakonisht për to familja është baza e shoqërisë, arsimimi dhe trajnimi vlerësohen shumë dhe të moshuarit kanë më shumë autoritet sesa të rinjtë dhe gratë. Ndërkaq, vendet me rezultate të ulëta promovojnë kreativitet dhe individualizëm të lartë. Njerëzit trajtojnë njëri-tjetrin si të barabartë dhe janë të gatshëm të ndihmojnë njëri-tjetrin në ekzekutimin e planeve dhe ideve më inovative.

### **1.2.6 Dimensioi i gjashtë – Inkurajimi i kënaqësisë kundrejt vetëpërbajtjes**

Përkufizimi i kënaqësisë i referohet shoqërisë e cila lejon një përmbushje relativisht të thjeshtë të të gjitha instinkteve natyrore njerëzore për të arritur kënaqësinë, argëtimin, shijimin. Përderisa, vetëpërbajtja apo kufizimi i referohet kontekstit të shoqërisë ku kënaqësitë e tilla shtypen dhe rregullohen me anë të normave strikte shoqërore. Ky dimension shfaq nivelin e kontrollit mbi dëshirat dhe impulset. Për shembull, vendet ballkanike figurojnë si kultura të vetëpërbajtura. Shoqëritë e tilla kanë tendencën të drejtohen për kah cinizmi dhe pesimizmi. Vetëpërbajtja konsiderohet përgjithësisht e pranueshme, ndërsa përmbushja e nevojave personale në njëfarë mënyre e gabuar.

### 1.3 Kultura politike

Përderisa politika është formë e jashtme dhe strukturore e ndërtimit të shtetit apo kombit, kultura është esenca e brendshme që i jep frymë dhe identitet. Kultura politike është “tërësia e vlerave, normave dhe njohurive, qëndrimeve dhe ndjenjave që përcaktojnë sjelljen politike ndaj sistemit politik.” (Verba: 1963: 14). Në mënyrë që shteti të jetë sa më afër parimeve demokratike duhet të ketë një kulturë të drejtë politike që të ekzistojë mirëqenia që i takon.

Në mënyrë që të elaborohet më qartë rrjedha e procesit transformues të shteteve të Evropës Juglindore nevojitet patjetër të analizohet edhe niveli i *kulturës politike* dhe i trashëgimisë kulturore, pasi këto dy gjëra kanë pasur ndikimin më të madh në krijimin e sistemeve të reja politike me modele më të hapura, të lira dhe më demokratike.

Sipas historianit Walter Hanisch, kjo lloj kulture është një “shumë e qëndrimeve, orientimeve dhe raporteve nëpër të ashtuquajturat procese dhe struktura politike” (Hanisch, 1976: 40). Nëpërmjet saj shprehen pikëpamje politike që kanë të bëjnë me botën, njerëzit, grupe më të mëdha sociale dhe grupe elitare. Kultura politike sipas disa të tjerëve është një tregues i nivelit demokratik të një shoqërie. Krijimi i një kulture të re politike mund të krahasohet me hyrjen në një rrugë të panjohur, ku nevojitet një proces i vazhdueshëm seleksionimi.

Disa studiues, mes të cilëve Sartori, Offe dhe Poveska, paralajmërojnë mbi paraqitjen e fenomeneve paradoksale gjatë lindjes së kulturës politike, të cilat janë mjaft interesante dhe specifike për çdo shtet dhe kulturë në veçanti. Një nga këto paradokse është pikërisht ai i nihilizmit, i një shoqërie të ezauruar nga aspekti emocional dhe shpirtëror, ku ekziston parimi i *mosbesimit*. Kështu, sa më e fortë të jetë elita për të nxitur qëndrime nihiliste kundër vlerave, aq më pak sukses do të ketë në integrimin e vlerave që ajo i konsideron më progresive. (Vajdenfeld 1999: 66) Në këtë rast, shoqërisë i pamundësohet të përkrahë ndonjë kauzë politike për shkak se është emocionalisht e ezauruar, ku mungesa e besimit të plotë te institucionet shtetërore mund të çojë drejt atij besimi mendjengushtë në një figurë të fuqishme karizmatike drejtuese.

Mirëpo, thonë studiuesit, meqë ky besim nuk mund të jetë afatgjatë pasi nuk ka rrënjë mjaftueshëm të thella, lindja e mosbesimit krijon deficit në besueshmërinë e fuqisë drejtuese dhe kjo gjendje mund të çojë në një sërë krizash ligjore dhe politike.

Sipas Hantingtonit konflikti politik në botë i shpjeguar nëpërmjet përplasjes së qytetërimeve, na paralajmëron se vendet lindore të cilat kanë një lidhje më të fortë me perëndimin, do të kenë më shumë sukses në zhvillimin e regjimeve demokratike. Disa studiues të tjerë këtë zhvillim pozitiv e lidhin më tepër me aspektin gjeografik, që do të thotë se vendet të cilat ndodhen fizikisht më afër, mund të bëjnë hapa më të shpejtë në procesin e demokratizimit.

Ndërkohë kemi dhe teori të tjera të cilat nuk marrin për bazë strukturën e vendeve, por më tepër aktorët politikë brenda tyre, duke konsideruar se struktura nuk është ajo e cila mund ta bëjë një vend demokraci apo diktaturë, por mund ta bëjë njerëzit. Kështu, disidenti rumun Gaspar Tomasia i referohet ndryshimit si një pasojë e aktivizimit të një mase liberale e jo të individëve të veçantë. Në studimet e Wolfgang Merkelit, vendet u përkasin tri grupeve: vendet me nivel të artë të kulturës politike, ku bëjnë pjesë edhe Sllovenia, Estonia, Çekia, Hungaria, Kroacia, Polonia, më pas vendet ku kultura politike është akoma në proces konsolidimi siç është Bullgaria, Rumania dhe Letonia dhe kategoria e fundit ku bëjnë pjesë vendet me standardet më të dobëta demokratike. Pikërisht në këtë kategori të fundit, Merkeli kategorizon shtetin tonë bashkë me Shqipërinë dhe Serbinë.

Disa autorë të tjerë të kësaj lëmie, shpesh herë i bazojnë dallimet kulturore në ndarjet mes vendeve katolike, ortodokse dhe myslimane, sidomos kur kultura politike shoqërohet me modele perëndimore. Dallimet e këtilla kanë zanafillën e tyre në histori, ku lindja karakterizohet kryesisht nga ortodoksizmi dhe perëndimi nga krishterizmi. Ato kanë pasur dhe ndikimet tyre në formimin e mënyrës së të kuptuarit të jetës, shoqërisë, komunitetit, solidaritetit njerëzor, parimeve morale si dhe raporteve të lirisë dhe besimit. Sipas Hantingtonit thuhet se nuk kemi të bëjmë me dy modele të kundërta, por me dy modele thjesht të ndryshme (Huntington 2011: 197)

Në këtë mënyrë, në lindje, trashëgimia e perandorisë bizantine krijoi raporte të fuqishme mes elitave politike dhe institucioneve fetare, kurse në perëndim dominonte më tepër besimi në bashkëjetesën mes institucioneve të fesë dhe shtetit laik. Nga ana tjetër, studiuesi Martin Mendelski bazohet mbi reformat institucionale në vendet e Evropës Juglindore duke shikuar dallimet si pasojë e trashëgimisë së perandorisë së Hapsburgut përkundër asaj osmane. (Mendelski 2007), duke theksuar se në vendet e ndikuara nga perandoria osmane, niveli i zhvillimit ekonomik është shumë më i ulët, grup në të cilin bëjnë pjesë edhe Maqedonia dhe Shqipëria, përkundër Sllovenisë dhe Kroacisë që kishin ndikim më hapsburgas.

Përplasja mes këtyre dy lloj kulturave në këtë mënyrë, pra, asaj lindore dhe perëndimore dhe identiteteve kombëtare të tyre ka luajtur një rol të rëndësishëm në procesin e krijimit të identitetit politik, një mënyrë të menduari dhe një mënyrë reagimi në atë mjedis të brendshëm politik. Me rënien e modelin kulturor osman, shumica e vendeve u detyruan të krijojnë elitë të re. Një shembull i tillë ishte modeli shqiptar i cili u lind në mesin e elitës së rënuar osmane për të mbajtur vazhdimësinë e elementeve të trashëgimisë kulturore.

Një ndër studimet e kësaj periudhe tranzitore të Evropës thotë se faktorët kryesorë përcaktues të politikës dhe jetës shoqërore pas rënies së këtyre perandorive të mëdha ishin si më poshtë: trashëgimia që lanë këto perandori, përzgjedhja e politikës dhe distanca nga mentaliteti i huaj, ndikimi i faktorit ndërkombëtar si dhe trashëgimia nga komunizmi. Thellë-thellë, ndonëse përpjekjet e shteteve të Evropës Juglindore drejtoheshin drejt një ndarje të plotë nga kultura osmane, trashëgimia e perandorisë ishte shumë më e fuqishme dhe ndikoi pothuajse të gjitha aspektet shoqërore: jetën sociale, të përditshme dhe marrëdhëniet ekonomike.

Në shembullin e Maqedonisë dhe të Shqipërisë, përpos osmanllinjve ajo që përbëri një element të rëndësishëm në formimin e kulturës politike ishte trashëgimia komuniste, që u pozicionua dhe si një nga pengesat kryesore në proceset e demokratizimit. Për shembull, izolimi që pësoi Shqipëria gjatë periudhës së saj komuniste, bashkë me mungesën e demokracisë, nguliti dhe rrënjosi vlera që nuk qenë shumë të favorshme për zhvillimin e asaj që quajmë demokraci.

Një tjetër fenomen interesant i pikasur nga shumë studiues në lidhje me Ballkanin është se ekziston *fenomeni i mosnjohjes dhe moskuptimit* midis atij dhe pjesës perëndimore të Evropës, meqë në periudha të ndryshme historike, kjo zonë ka qenë e shkëputur kulturalisht dhe politikisht.

### **1.3.1 Kultura politike si element funksional për demokratizimin e shoqërisë shqiptare**

Meqënëse identiteti ynë na lidh gjithmonë më afër me nocionin e kulturës, do të ishte më se normale të merrnim si model shoqëror për të analizuar shoqërinë shqiptare, duke qenë dhe një nga shoqëritë ekzistuese në gadishullin ballkanik. Kjo shoqëri, meqënëse vjen nga një sistem totalitar komunist, edhe pas ardhjes së demokracisë në vitin 1990, vazhdoi të kishte elemente diktatoriale dhe mentalitet nënshtrues i cili dominonte në jetën qytetare. “Prandaj nevojitet”,

sipas Kocanit, “të bëhet një *katarsis* i vërtetë filozofik në shoqërinë shqiptare, do të thotë të zëvendësohet periudha e vjetës komuniste në kujtesën e tyre me një përmbajtje të re” (Kocani: 2003)

Sot, totalisht ndryshe nga dje, realitetin politik shqiptar e formëson një shoqëri e re demokratike ku gëzohet e drejta e lirë e çdo individ apo grupi. Shtetasit e një shoqërie të këtillë të litë ndjekin intereset e tyre personale dhe krijojnë vizione të pavarura për jetën brenda apo jashtë shtetit si dhe përcaktojnë prirjen e tyre jetësore në bazë të dëshirës dhe preferencave, si për shembull në filozofi, art, politikë apo shkencë. Është e rëndësishme të theksohet dukuria se ndihma më e madhe që demokracia dukshëm u jep njerëzve është arti dhe liria për të krijuar vepra artistike, që të mund të zbulohet ajo botë e pafundme e shpirtit të njeriut dhe misteret e mendjes njerëzore. Veç kësaj, një pjesë tjetër shumë e rëndësishme e përbërjes së demokracisë së sotme shqiptare është arsimi i çdo shqiptari në mënyrë që të lindë ajo kulturë demokratike e shumëdëshiruar. Modeli për shkallën e duhur arsimore është ai evropian, pasi konsiderohet se arsimi evropian orienton formimin e qytetarëve në një botëkuptimi të lirë, të pavarur, kritik, me ide dhe vizione, koncepte dhe praktika.

Duke marrë shqiptarët si model, mund të pikasim faktorët të cilët pengojnë zhvillimin e mirëfilltë të kulturës politike: mungesa e infrastrukturës adekuate dhe mungesa e politikave efikase për ndërgjegjësimin e popullsisë. Duhet bërë e qartë se “demokracia në vetvete nuk është gjë tjetër, veçse një sërë rregullash për zgjidhjen e konfliktit me kulture demokratike. (Veselaj, 2002: 21)

Në aspektin e kulturës politike, demokracia ofron dhe çelësa për të zgjidhur këtë konflikt me anë të rregullave dhe ligjeve të caktuara për të sjellë kompromis, konsensus apo lloje të tjera marrëveshesh. Megjithatë ky proces *shërimi*, për një shtet si Shqipëria apo ndonjë të ngjashëm me të në këtë aspekt është i vështirë përderisa grupe dhe individët e shohin demokracinë si një lloj mënyre për të realizuar intereset e tyre, atëherë shoqëria në tërësi do të jetë e destinuar të shkatërrohet në një mënyrë shumë katasrofale.

Në të njëjtën kohë ky konflikt duhet të zgjidhet brenda rregullave, kodeve, ligjeve të caktuara dhe të sjellë kompromisin, konsensusin apo marrëveshje të tjera ndërpartiake, që gjykohen nga të gjitha palët si të ligjshme e të pa kontestuara. Për të gjitha këto që thamë kërkohet, në themel, kulturë politike, gjë që ne shqiptarëve ende na mungon. Në qoftë se grupet, individët, partitë

politike etj., e shikojnë demokracinë në rastin tonë, në Shqipëri, vetëm si forum ku ata kërkojnë realizimin e interesave, kërkesave të ngushta personale, shoqëria në tërësi është e destinuar të shkatërrohet nga brenda në mënyrë katastrofale.

Nëse qeveria, siç ndodh në aktualitet përpiqet të ushtrojë mbi votuesit dhe kandidatët ndonjë lloj dhune policaore për të arritur një konsensus, atëherë kjo shoqëri shqiptare do të shkatërrohet nga lart si arsye e një diktati të kundërt me demokracinë.

Sidomos në shtetin shqiptar, demokracia nuk arrin të funksionojë vetë, me parimet dhe rregullat e saj, pasi ekzistojnë akoma praktika komuniste të një lloj etejeje për pushtet të përjetshëm. Sipas teoricienëve një zgjidhje shumë e mirë për demokracinë është krijimi i koalicioneve të cilat mund të realizojnë *kompromis*, në mënyrë që këto grupe të mund të punojnë brenda një kuadri kushtetues.

Nëse këto rregulla nuk zbatohen atëherë shoqëria është e destinuar të përjetojë vazhdimisht forma të ndryshme paradoksesh, si për shembull: *paradoksi i ni, hilizmit të dyfishtë, paradoksi i instrumentalizmit të dyfishtë, paradoksi i ideologjisë utopike, paradoksi i mungesës së një rendi të fortë kushtetues, paradoksi i anarkisë burokratike, paradoksi i marrjes së vendimeve, paradoksi i një shoqërie të konsumuar emocionalisht, si dhe paradoksi i mosbesimit.*



## 1.4. Elementet e kulturës

### Kultura materiale, vlerat dhe sjelljet, zakonet, estetika

Prodhimtaria njerëzore bazohet në dy lloje, ajo materiale dhe ajo jomateriale. Me anë të kulturës materiale ne nënkuptojmë të gjitha ato objekte të cilat njerëzit i prodhojnë dhe u japin një kuptim, duke nisur kështu nga më të thjeshtat si tavolina apo karrigia e deri te kompjuteri apo anija kozmike. Mirëpo e vërteta është se jo të gjitha këto objekte kanë po të njëjtin kuptim gjithande dhe kështu, për shembull, në një shoqëri që nuk njeh të shkruarit, *lapsi* nuk ka kuptim.

Nga ana tjetër, kultura jomatariiale nënkupton të gjitha ato produkte abstrakte brenda një shoqërie, por jo dhe më pak të rëndësishme, siç janë idetë, besimet, gjuha apo muzika. Kulmi i këtij grupi janë *vlerat*, pasi ky kuptim është më i vështiri për t'u arritur dhe ndryshon në epoka të ndryshme historike.

Të gjithë ne lindim në një ambient kulturor dhe aty mësojmë se si të sillemi, mësojmë mbi disa *modele kulturore* të cilat na orientojnë në shoqëri. Në këtë mënyrë kultura ndikon jetën e njeriut duke u materializuar nëpërmjet përditshmërisë së tij. Pa pasur modele kulturore, njeriu do të ishte i humbur dhe asnjë grup njerëzish nuk do të mund të mbante gjallë specifikat e tij kulturore. Këtu lind koncepti i *identitetit* në kulturë.

Në shoqëritë tradicionale “të mbyllura”, ku normat e transmetuara ishin të ngurta dhe çdo gjë e re ishte shumë e limituar, thuhet se identiteti krijohet në periudhën adoleshente. Por e vërteta është se identiteti është në proces të vazhdueshëm transformimi, pasi sot jetojmë me shumë mundësive për të përjetuar eksperiencë dhe mundësive për të ndryshuar. E meqenëse natyrë e njeriut është shumë elastike, edhe identiteti i tij shpesh herë është pasojë e ndërveprimit me gjenetikën dhe kulturës. Mund të themi se identiteti është një *bricolage*<sup>1</sup>, një ndërthurje fragmentesh të ndryshme të së resë dhe të vjetrës brenda jetës njerëzore, si dhe të shumë materialeve simbolike me të cilat krijojmë kontakt gjatë jetës sonë.

Disa thonë se kjo mënyrë kompozimi, pra ky bricolage, mund të sjellë shkatërrimin e identitetit njerëzor. Mirëpo duhet të analizohet dhe fakti se jo gjithmonë humbja e identitetit tonë të vjetër është negative, por është një proces i cili na liron duke na lejuar të rigjejmë veten tonë gjithmonë e më shumë.

---

<sup>1</sup> Bricolage, nga frëngjishtja “kompozicion”, “ndërtim”.

Njëkohësisht, ekzistojnë edhe të ashtuquajturat *identitete kolektive* apo *identitete nacionale*. Shpesh herë, megjithatë, ky lloj kategorizimi pamundëson gjetjen e identitetit më të veçantë kulturor apo madje edhe individual, duke mohuar shumë identitete të tjera, e duke e përdorur konceptim për qëllime politike dhe ekonomike. Nëse fokusi i studiuesve të kulturës do të ishte i këtillë atëherë identiteti kulturor do të ishte diçka e cila shpalosej në mohim e tutje, pra siç thotë njëri nga studiuesit e mëdhenj, do të lind nga ajo histori e cila është *hidhërim i njeriut*. (Quenau: 1959)

Sot shumë herë dëgjojmë të flitet për një shoqëri kulturore kundërshtare, që shpesh prodhon të ashtuquajtura *identitete kulturore kundërshtare*. Në mesin e këtij këndvështrimi negativ, ajo që paraqitet si një formë shprese është utopia e të pasurit një ëndërr e cila i paraprin realitetit dhe e ndihmon të konkretizohet. Një ëndërr për bashkim, komunikim dhe një tolerancë aktive mes të gjitha kulturave, aktualisht të nxitur dhe të ushqyer kryesisht nga artistët, shkrimtarët, jo mediat dhe politika.

Fraza e Niçes nga vepra e tij “Kështu foli Zarathustra” mund të aplikohet në aspektin ballkanik: *Njeriu është një urë, jo një qëllim*. Një studiues i Bullgarisë të kësaj fushe shprehet: *Çfarë drame që fshihet në atë urë kalimi, por njëkohësisht sa shumë fuqi! Fuqia jonë!*

## 1.5. Globalizmi kulturor

Të gjithë besuan se pas ideologjive të shekullit të njëzetë si komunizmi dhe nazizmi, do të vinte një periudhë qetësimi apo *postideologjike*, si shpresë se me këtë do të krijohet një frymë e re e cila do të përfaqëonte konceptin multikulturor. Ndërkaq, çështja e multikulturalizmit konsiderohet në dy aspekte të kundërta: 1) si globalizëm dhe 2) si forca e madhe e identitetit. (Solar, 1976:20)

Marrëdhënia e globalizmit dhe interkulturalizmit janë shumë të ndërlikuara dhe shumë herë konfuzë. Në të shumtën e rasteve edhe këtu lindin shumë paradokse, ku shtetet janë mes dy rrugëve. Nga njëra anë duan të marrin pjesë në punë globale, kurse nga ana tjetër duan të mbështeten edhe te potenciali i tyre vetjak.

Të gjithë ata popuj të gadishullit ballkanik të cilën u ndodhën në një situatë të vështirë në kohën e tranzicionit, sot gjenden para sfidave të cilat fatkeqësisht nuk ofrojnë zgjidhje të menjëhershme. E ardhmja e tyre mbetet e hapur në masë të madhe, duke u varur nga fakti nëse mundet ose jo të gjendet një harmoni mes globalizmit dhe identitetit të tyre të fuqishëm.

Në disa teori kulturore, *multikulturalizmi* konsiderohet si një iluzion i madh. Ndonëse globalizmi nuk ka krijuar një formë definitive në ekzistencën e tij ai kalon nëpër shumë faza. Së pari, globalizmi konsiderohet një proces i kapërcimit të kufijve historikë dhe kjo vlen sidomos për kufijtë e vendeve të ballkanit, pasi këta janë kufij të cilët akoma tërheqin luftra të përgjakura. Pikërisht për këtë arsye, kur globalizmi konsiderohet në korniza ballkanike, paraqitet me një ashpërsi të madhe i cili punon për ta ngritur nivelin e jetesës.

Ekspertë të ndryshëm kanë thënë se globalizmi është i domosdoshëm nëse vendet duan të lulëzojnë dhe të kenë liri. Rënia e eksperimenteve të natyrës kolektiviste të shekullit njëzet si komunizmi, nacionalizmi dhe fashizmi dhe efekti i tyre i thellë negativ në raport me pasurinë dhe lirinë e çdo kombi, tashmë është e njohur. Çdo model i ashtuquajtur *statist* shtetëror është karakterizuar nga restriksione të fuqishme të rrjedhës së informacionit. Për më tepër, marrëdhënia ndërmjet ekonomisë dhe individit ishte themeli për të gjitha sistemet demokratike liberale. Kalimi i kohës ka bërë të qartë se konsolidimi i tyre është si etik, ashtu edhe praktik.

Por, çfarë mund të themi se është një kulturë e mirëfilltë politike? Një shtet i fortë, sipas Adam Smith dhe Douglass North, është ai i cili operon në tri fusha kryesore: 1) sigurimi i të mirave publike, 2) brendimin e pamjeve të jashtme dhe 3) ndihma kundrejt njerëzve.

Nga mesi i shekullit nëntëmbëdhjetë deri në Luftën e Parë Botërore u nxit një periudhë paqeje dhe rritje ekonomike, që u quajt dhe vetë *Periudha e Artë e sigurisë dhe lirisë*. (Zweig, 1941:50) Kjo valë e parë e globalizmit sigurisht që u përbë fillimisht nga ato shtete që janë anëtare të OECD dhe rezultoi me rrjedha masive migruese, pasi nga viti 1850 deri në vitin 1914, 60 milionë njerëz lanë Evropën për të shkuar në SHBA, Oqeani apo në jug dhe lindje të Afrikës.

Kështu, pas një rritjeje të liberalizmit në shekullit e nëntëmbëdhjetë, u kombinuan idetë kolektivistike, lufta, çrregullimi monetar dhe krizat ekonomike për të refuzuar idetë, politikat dhe besimet të konsoliduara më parë nga regjimi liberal ekonomik *laissez – faire*<sup>2</sup>. Me anë të kësaj, kapitalizmi ishte duke përfunduar, pasi fuqitë e mëdha krijuan sisteme ekonomike që rforcuan sundimin e tyre për t'i mbrojtur nga rivalët. Multilaterizmi u zëvendësua nga dyanshmëria apo *bilaterizmi*, tregtia e lirë nga proteksionizmi, liria e kapitalit nga kontrolli në këmbime, standardi i arit me banknota dhe lëvizja e lirë e punës me shtrëngime të fuqishme. Kjo, pra, ishte bota e re, *parajsa kolektiviste* e krijuar nga fuqitë antiglobaliste të mijëvjeçarit të ri.

---

<sup>2</sup> *laissez faire* – nga frëngjishtja, një sistem ekonomik në të cilin transaksionet mes palëve private janë të lira nga ndërhyrja qeveritare që zakonisht ka formën e rregullave

## 1.6. Restaurimi i rregullit global liberal

Thuhet se rrënjët e globalizmit dhe rinovimit të gjendjes politike duheshin gjetur nën sulmin e pengesave të shumta për lëvizjen e mallrave dhe kapitalit, kështu liberalizmi i ri filloi me tregtinë ndërmjet atyre vendeve me të ardhura më të larta dhe gradualisht u përhap në vende të tjera të botës gjatë viteve të 80' dhe 90' në formën e tregtisë dhe rrjedhës së kapitalit.

Megjithëse globalizmi nuk është i pandalshëm, ai dukshëm mbetet i kufizuar dhe ekziston një pajtim i gjerë mbi faktin se mbizotërimi i pengesave për lëvizjen e lirë të kapitalit, njerëzve, shërbimeve apo mallrave është në dëm të shteteve më të varfra. Prandaj mund të thuhet se liberalizmi ndërkombëtar nuk është i mjaftueshëm për një shtet të shëndetshëm në promovim të prosperitetit. Me pak fjalë, ekonomia e tregut nuk ka nevojë vetëm për politika të mira, ekonomi dhe tregje të hapura, por gjithashtu edhe për qeverisje të duhur dhe një kuadër të besueshëm institucional, që është transparent dhe i parashikueshëm në veprimet e tij. Shteti është krijuar për t'u shërbyer qytetarëve dhe është i detyruar t'i mbrojë ata nga çdo lloj dëmi, duke përfshirë edhe vetveten, pasi një globalizim më i mirë kërkon edhe një shtet efikas.

Duhet të themi se rrymat kundërshtuese të globalizmit në përgjithësi ndahen në dy fronte: nga njëra anë kemi interesat e modës dhe trendeve të tilla si bashkimet tregtare, interesat proteksioniste ndërsa në anën tjetër, më të rëndësishme në ditët e sotme, ndodhen OJF-të apo të ashtuquajturat *kolektivitete të mijëvjeçarit të ri*. Në këto të fundit përfshihen socialistët, neomarksistët si dhe merkantilistët, macionalistët dhe grupet anti-liberale që luajtën një rol të rëndësishëm në rrëzimin e rendit liberal në fund të shekullit XIX.

Në një pamje të tërësishme shohim se kemi të bëjmë me një lëvizje anti-globaliste e cila është e bazuar krejtësisht mbi ide dhe jo veprim. Ajo nuk ofron një mënyrë alternative për drejtimin e ekonomisë, por vetëm ndjenja, emocione dhe protesta. E vërteta është se të gjitha grupet e lartpërmendura kërkojnë ndonjë formë postndriçuese të kulturës, organizimit apo besimit, pasi për ta idetë kanë rëndësi, dhe ky koktej ideologjik Molotov<sup>3</sup> është i rrezikshëm për një shoqëri të hapur.

---

<sup>3</sup> Molotov – i referohet bombës Molotov - bombë artizanale që shkakton një dëm të menjëhershëm dhe krijon panik, e përdorur zakonisht nga guerrillasit urbanë dhe nga protestuesit e dhunshëm në sheshe.

Për aq kohë sa shteti mundëson shërbime të cilat gëzojnë qytetarët, ai do të duhet të vazhdojë të ndërhyjë dhe të tatojë, siç e tregon edhe përvoja e shteteve me mirëqenien më të madhe në Evropën veriore. Aftësia për të rritur tatimet dhe për të ruajtur ato raporte të larta të shpenzimeve publike varen nga populli dhe jo aq nga globalizmi. Për më tepër është e mundur të ruhet një masë e lartë e tatimeve dhe sigurimit shoqëror edhe në një ekonomi të hapur. E vetmja gjë që arrin të bëjë integrimi ndërkombëtar është ta bëjë politikën ekonomike më të parashikueshme dhe transparente ashtu si qeverinë.

Në shumë aspekte kapitalizmi ka qenë më pak dëmtues se socializmi. Bashkimi Sovjetik ishte përgjegjës për katastrofat më të mëdha mjedisore në histori. Dëmet që bënë të ashtuquajturit *kuq-jeshilët* nuk lidhen në ndonjë mënyrë të dukshme apo të padukshme me globalizmin, porse më tepër me varfërinë dhe qeverinë e dobët. Nuk ishte liberalizmi që shkaktoi shpyllëzimin, por fshatarët pa tokë dhe të varfër. Sigurisht që ekzistojnë edhe probleme reale të mjedisit, por këtu nuk mund të përdoren zgjidhjet e tregut. Ajo që nevojitet është marrja përsipër e përgjegjësisë dhe shpenzimeve nga vetë shteti.

Të gjitha ekonomitë e vendeve emergjente kanë bërë përpjekjet e tyre për t'u integruar në tregjet botërore të kapitalit duke pësuar kriza shumë të mëdha, por do të ishte shumë e thjeshtë dhe me shumë gjasa e gabuar të konkludohej nga kjo se leksioni për të nxjerrë nga kjo është *mosliberalizmi*, sepse integrimi në tregjet ndërkombëtare është në interesin e të gjitha vendeve. Vendet në zhvillim, duke përfshirë edhe shtetin tonë do të duhet të rimendojnë rregullat e tyre të brendshme, legjislacionin dhe qëndrimet në raport me rolin e bankave dhe rolian e institucioneve të huaja financiare.

Sa u përket rebelimeve qytetare, duhet thënë se është më e lehtë të luftosh një ushtri se sa një forcë guerile dhe kolektivistët e rinj janë të karakterizuar nga mijëra kontradikta të lloj-llojshme, gjë e cila e bën konfrontimin me idetë e tyre shumë të vështirë, pasi ata mund të sulmojnë nga të gjitha drejtimet.

## KAPITULLI 2

### **Kultura, integrimet dhe Ballkani**

Padyshim koncepti më i dalluar i nxjerrë nga fjala *Ballkani* është *Ballkanizmi*. Kjo si arsye se nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, gadishulli fut në përdorim gjithnjë e më dhumë konotacionin politik dhe jo të pastër gjeografik, për të përshkruar ato shtet që u krijuan pas rënimit të Perandorisë osmane. Sidomos pas shpërbërjes së Perandorisë së Hapsburgut, shpejtësia me anë të së cilës shpërthenin shtetet e vogla u rrit edhe më shumë. Megjithatë, njëkohësisht me këto, duhet përmendur edhe procesin teknikisht të kundërt me ballkanizimin, që ishte krijimi i Jugosllavisë.

Në gjysmëne dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, termi *Balkanofilia*, u zëvendësua me termin *Balkanofobia* dhe të gjitha revolucionet nacionaliste që dolën me krijimin e shteteve të reja duke bërë që ambiciet e tyre të nxisin konflikte të shumta, sidomos territoriale dhe etnike dhe kulminimi i tyre ishin të ashtuquajturat *luftrat Ballkanike* nga viti 1912-1913.

Në këtë krizë së botës bashkëkohore shohim një rritje në rëndësinë e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendeve anëtare por edhe të vendeve aspirante. Debatet mbi *zgjerimin* apo *moszgjerimin* vijnë të jenë prezente në fokusin e politikës së Bashkimit Evropian. Arsyeja e krizës së shumë shteteve është rrjeti ndërkombëtar ekonomik dhe bashkëpunimi përtej kufijve dhe përveç këtyre debateve, sot është pothuajse e pamundur të frenohen pasojat e përgjithshme të globalizmit. Siç thonë disa studium, e ardhmja dhe gjithashtu shpëtimi i Evropës ndodhet te zgjerimi i saj, sigurisht pas përmbushjes së kritereve të përcaktuara. Kështu edhe bashkëpunimi i Ballkanit me synim integrimin mund të kontribuojë në stabilitet dhe qëndrueshmëri më të madhe ekonomike.

## 2.1 Diskontinuiteti në zhvillimin e kulturave ballkanike

Pas dy luftërave botërore e gjithë Evropa u përfshi në një vorbull humbjesh si ekonomike ashtu dhe njerëzore, deri sa numri i viktimave arriti deri në 40 milionë, gjysma e të cilëve ishin civilë. Sa u përket shkaqeve, ato ishin të shumta. Ndër to mund të përmendim shkaqet ekonomike, politike, fetare, territoriale apo racore. Kështu, Evropa u gjend papritmas para vështirësive kaq të mëdha ekonomike ku bujqësia ishte krejtësisht e rënuar dhe mungonin lëndët e para dhe ushqimi. Kontinenti evropian ndodhej në një udhëkryq pa ditur se çfarë politikash do të ndiqte më tej. Si do të mund të parandalohet një rikthim i konfliktit të tillë e të rilindte një qytetërim i ri evropian? Si një zgjidhje e vetmje logjike ishte bashkimi dhe integrimi i të gjitha shteteve.

Ideja e integritit buroi nga baballarët e integritit evropian – Jean Monnet dhe Robert Schuman. I pari inicioi dhe organizoi Komunitetin evropian të qymyrit dhe hekurit, për të transformuar Evropën nga një vend i shkatërruar në një vend paqeje, lirie dhe prosperiteti. Shumë nga idetë e Monnet janë themelet e Bashkimit Evropian. Ai sugjeronte bashkimin dhe integrimin si veglat më të mira për të zhvilluar ekonominë dhe mirëqenien, duke ndjekur një politikë të përbashkët. Ndërsa Schuman kishte plan që të krijonte një Evropë e cila do të ishte nën kontrollin e një *institucioni mbinacional*. Sipas tij, idetë e të cilit gjithashtu kontribuan në themelet e Bashkimit Evropian, kufijtë që ndajnë shtetet dhe kombet nuk duhet të jenë pengesë mes popujsh dhe kulturash. Ai thoshte se duhet t'i jepej fund një herë e përgjithmonë konceptit të *armikut historik* dhe se ardhmja duhej të ndërtohej me bashkim.

Mënyra se si u arrit kjo ishte nëpërmjet Traktatit të Romës në vitin 1957, i cili plotësoi bashkimin doganor, me lëvizjen e mallrave, shërbimeve dhe kapitaleve. Ky akt ishte një nga shumë marrëveshje që do të vijonin dhe pikënisja për suksesin dhe rimëkëmbjen e Evropës. Dy rryma që ndikuan në integrimin evropian janë: *rryma federaliste* dhe *rryma e shteteve sovrane*.

Sipas asaj federaliste, nëse Evropa do të ngrihej mbi baza sovraniteti të komb-shteteve, kjo do të sillte në të ardhmen shumë luftëra, ndërsa një integrim i formës federale do të largonte kontinentin nga krizat dhe luftërat. Njëkohësisht edhe shpenzimet e armatimeve do të bëheshin shumë më lehtë me anë të bashkëpunimit mes shteteve, duke ulur kostot e fuqizimeve. Rryma e shteteve sovrane thoshte se shtete e udhëhequra mëvetësisht ishin një formë shumë e mirë



përfaqësuese dhe se integrimi dhe bashkimi duhej të bëheshin vetëm në aspekt ekonomik, duke ua lënë kompetencat qeverive me qeverisje të paanshme.

Ty dy rrymat kishin bazat dhe mbështetjet e tyre argumentuese. Mbështetësit e rrymës federaliste ishin shtetet e humbura si Belgjika, Luksemburgu, Franca, Gjermania, Italia, Holanda dhe Austria, kurse qeveritë më të sofistikuara mbanin anën e rrymës sovrane për të shmangur pushtimet e huaja dhe humbjet e jetëve njerëzore, si Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia dhe Danimarka.

### KAPITULLI 3

#### ***Modus Vivendi* për kohezionin dhe integrimet evropiane**

Në kohën e tashme ne përjetojmë disa ndryshime të thella të paradigmeve në të gjitha sferat e jetës, të cilat para së gjithash janë drejtpërdrejt të lidhura me globalizimin dhe proceset botërore politike. Në Evropë shfaqen procese pjesërisht të drejtuara drejt një qëllimi dhe pjesërisht të drejtuara drejt qëllimeve të kundërvënë, të cilat fitojnë etiketën, që deri më tani shërbente për të karakterizuar Ballkanin: *Njëkohësi e paraqitjeve jo të njëkohshme..*

Ky fakt ka të bëjë me orientimin kontradiktor dhe mënyrës së jetesës, e thënë më saktë – të atij paradoksi të afrimit gjithmonë e më të madh mes evropianëve të perëndimit me format e tyre të jetesës, përderisa njerëzit e Evropës lindore hapërojnë në drejtim të kundërt: ata ecin drejt rrugës së ndarjeve dhe kufizimeve nga njëri tjetri, gjë e cila ndodhi pas shpërbërjes së shteteve dhe pastrimit etnik, gjegjësisht me krijimin e shfaqjeve monoetnike, theksimin e dallimeve, urrejtje dhe shkatërrime të ndërsjella.

Kur flasim për një *modus vivendi*, apo një hapërim të përbashkët drejt një mjedisi ku mbizotëron toleranca dhe dëshira për integrim në shumë aspekte me njëri-tjetrin, atëherë këto diferenca si historike, si aktuale fillojnë dhe zbehen, pasi fuqia e cila i mbante në këmbë nuk është më ekzistente. Një model i përbashkët është ai i ngritur mbi të përbashkëtën, pra mbi vlerat të cilat konsiderohen të jenë shtylla të çdo bashkimi dhe procesi i cili priret të jetë më tepër demokratik, që i kushton më shumë vëmendje asaj sfere të jetës e cila është njerëzore, humane dhe progresive duke përfshirë këtu edhe nivelin ekonomik.

Shumë situata dhe faktorë që kanë dalë si rrjedhojë e luftërave dhe globalizmit do të shkriheshin në këtë model, pasi këtu mbizotëron pozitiviteti për të bërë një ndryshim të përbashkët dhe në shumicën e rasteve u jepet prioritet pikërisht atyre aspekteve, mund të themi në shumë raste politikisht të harruara të cilat me një emër të vetëm quhen *kulturore ballkanike*.

Ashtu sikurse dikush ndjen tolerancën, solidaritetin dhe barazinë njerëzore në shtetet më të përparuar të veriut të kontinentit, ashtu dhe në Ballkan mund të ekzistojë një e ardhme e tillë e cila pjesërisht, të mos harrojmë – vetëm pjesërisht – bazohet në mirëqenien ekonomike që do të fitojë nga stabilizimi nën normat e fuqisë mbinacionale të Bashkimit Evropian. Pjesa tjetër i mbetet zhvillimit kulturor, pra pikërisht ndryshimit të mentalitetit me të cilin secili prej ballkanasve shikon kulturën, zhvillimin, jetën dhe vizionin që ka për rritjen dhe progresin.

Është e lehtë të flasim për bashkim teorikisht duke e ditur se hapat të cilat na presin janë të vështirë dhe lehtë të arritshëm me metodat e korrupsionit të cilat fatkeqësisht janë bërë si damka e përjetshme e Ballkanit dhe Evropës juglindore. Mirëpo, është e vështirë të kthesh njeriun kundër vetvete dhe të të marrë në pyetje njohuritë dhe vetëdijësimin e tij mbi kulturën, rëndësinë e kulturës, rëndësinë e kombit, rregullave, ligjeve natyrale që i kanë takuar secilit të ketë në këtë tokë që quajmë Ballkan.

Sa më shpjetë dhe në mënyrë të përbashkët të ecin zhvillimi ekonomik me atë zhvillim në mentalitet, aq më të shëndetshme do të jenë kalimet në çdo sferë integruese, mbase në të ardhmen edhe më e madhe se Bashkimi Evropian. Baza argumentuese në këtë tezë është se ekonomia i jep njeriut një bazë fillestare mirëqenieje dhe një siguri materiale me për jetën, kurse vetëdijësimi i ushqyer dhe i nxitur nga një sistem edukues dhe arsimor, i cili përsëri nuk lidhet aq me zhvillimin ekonomik sa që lidhet vullnetin e lirë të njeriut *për të qenë një urë* (rithërrasim Niçen), i cili do të ndryshojë këndvështrimin dhe mentalitetin kundrejt kulturës.

### **3.1 Modeli kulturor ballkanik dhe konvergjenca e kulturave ballkanike**

Duke marrë parasysh zhvillimin e këtyre në tragjedinë më të re në hapësirën jugosllaveve dhe ngjarjes e tanishme në Maqedoni, për kërkuesit kulturorë, të cilët merren me Evropën juglindore, një detyrë e rëndësishme është thërritja e *të përbashkëtës* në vetëdijen e tyre, me qëllim që të krijohet një urë mendore dhe një rrugë e cila çon nga njëra anë te tjetra.

Në këtë kontekst, etnologjia ballkanase është një disiplinë shkencore, e cila në bazë komparative studion kulturat e kësaj hapësire. Tanimë për një kohë të gjatë kjo disiplinë, duke u bazuar në hulumtime të ndryshme ka konstatuar se popujt ballkanikë, pavarësisht dallimeve të mëdha në identitetin e tyre etnik dhe nacional, posedojnë shumë elemente të përbashkëta gjuhësore dhe kulturore. Një fenomen i këtyre nuk mund të vihet re në asnjë vend tjetër në Evropë. Këto elemente janë të rrënjësura thellë dhe mund të dallohen sot në shumë sfera të jetës së përditshme.

Duhet theksuar se e përbashkëta nuk lind vetëm si një nevojë, por si një domosdoshmëri për çdo shoqëri të e cila i afrohet asaj që quhet shoqëri utopike, pasi një shoqëri edhe filozofikisht e marrë, nuk mund të jetojë i vetmjaftueshëm dhe i duhet të kalojë në procesin e bashkëpunimit dhe integritit për të kuptuar se është pjesë e diçkaje që kalon kufijtë individualë dhe kolektivistë dhe shkon në një dimension shpirtëror apo mendor ku idealet njerëzore përcaktojnë rregullat që do të zbatohen si pasojë e tyre.

Rëndësia e të pasurit një model të tillë është thellësisht e brendshme dhe njerëzore pasi prej atë që brenda njeriut nuk ka maskë dhe kufi, që lidhet me mendjen, zemrën dhe kuptueshmërinë e tij për jetën dhe që e ka ndjekur njeriun si nevojë përgjatë gjithë historisë që në zanafillat e para historike.

Kur trajtohet Ballkani, bukur e thënë, kjo gjellë e pëzier, apo si i thonë turqit kjo *turlitavë* kulutrash, modeli i tij kulturor duket i larmishëm, gjë që njëkohësisht e bën edhe tejet të pasur. Gjuha, muzika, mitologjia dhe shumë aspekte të tjera të cilat janë rritur në historinë e lashtë dhe vazhdojnë të rriten dhe zhvillohen edhe tani, megjithëse jemi shumë më pak të vetëdijshëmmbi këto fenomene, janë ato që ndërlidhin dhe mbajnë gjallë vatrën e padukshme të mirëkuptimit, mirëbesimit dhe bashkimit natyral i cili i paraprin çdo bashkimi tjetër *të jashtëm*.

### 3.2 Aspekte të bashkëjetesës ndër popujt ballkanikë në prizmin e besimeve

Njeriu si qenie nuk është vetëm një *zoopolitikon*, siç pretendonte Aristoteli, por gjithashtu dikush që i shton pyetje vetes mbi gjërat e kësaj bote, si ato që logjika e tij arrin të kuptojë, si ato që janë të paperceptueshme për të. Në këtë aspekt të kahmoçen *fetar* të kulturës mund të analizohen shumë fije bashkuese mes kulturave të ndryshme, sidomos në gadishullin e Ballkanit.

Thuhej se Ballkani kishte fe pagane, e cila rregullonte marrëdhëniet mes njeriut dhe natyrës, prandaj dhe ballkanasit e lashtësisë respektonin dhe i adhuronin fuqitë e natyrës. Koncepti fetar ishte politeizmi, apo besimi në shumë perëndi dhe nuk kufizohej me rregulla klerikale. Kjo lejonte që mirësia dhe bukuria të pranoheshin në kuadrin e tërësisë dhe feja të mos qëndronte si diçka supreme por si fija ekzistenciale dhe gjallëruese e vetë shoqërisë. Për këtë arsye, si të tillë ballkanasit ishin mikpritës edhe të religjioneve të tjera të lindjes.

Me lindjen dhe përhapjen e feve monoteiste me një nga pikënisjet pikërisht në mesdheun lindor, paganizmi i Ballkanit u struk nëpër fshatra, ndërkohë që dhespotizmi pushtoi qytetet. Krishterimi nënkuptonte një set morali supranacional. Tri elementet e Krishterimit që ishin qyteti, liturgjia dhe jeta askete bënë që Ballkani i cili deri në atë kohë kishte qenë pagan të organizohej në një formë shumë të rreptë, hierarkike. Me ndaren e dy peshkopive qendrore Romës dhe Stambollit, organizimi i mëtejshëm në Ballkan u krye nën udhëheqjen e Carigradit, kurse Roma edhe në këtë këndvështrim mbeti *mbarëbotërore*: duke marrë shembullin e një shteti botëror romak.

Organizimi i rendit klerikal fillimisht zhvillimin e tij në Ballkan e nisi nën udhëheqjen e Carigradit me principet popullore. Roma edhe në këtë pikëpamje mbeti mbikombëtare: duke marrë shembullin e shtetit botëror romak. Me pak fjalë, feja e vërtetë e Ballkanit pas zhdukjes së paganizmit, ishte Krishterimi, me bazë themelore tolerancën popullore dhe quhej krishterim mbinacional.

Me ardhjen e Perandorisë Osmane në Ballkan zuri rrënjë edhe feja islame me karakteristikën e saj kryesore – veprat bamirëse, një karakteristikë dhe mentalitet që ndikoi të gjithë Ballkanin duke përfshirë edhe fetë e tjera. Jo më kot Ballkani shquhet për ngrohtësi, bujari dhe mikpritje. Madje Islami kishte edhe një tjetër veçori të veçantë. Gjatë kohës që Islami ishte një fe

mbinacionale në Ballkan proverbi i njohur *Vëllai i dashur është, i cilësdo fe qoftë*, ishte një parullë e mirënjohur.

Duhet theksuar se zemërgjerësia nuk nxitej vetëm nga feja, por edhe nga hapësira gjeografike. Gjithçka që ishte zemërngushtësi në realitet nuk përkonte me Ballkanin. Në Ballkan duhet të mbahet në pedestal toleranca humane e jetës, si gurthemeli më i rëndësishëm i kulturës së tyre. E përbashkëta në Ballkan më së miri pasqyrhet në gjuhët dhe kulturat e ndyshme të të jetuarit, siç janë të ngrënit, zakonet, poezia, muzika dhe vallja. Akoma edhe konceptet mendore janë të përbashkëta siç është lëvizja e kokës poshtë-lartë (për pohim), apo me një hedhje të saj pas shpatullave duke artikuluar një pasthirmë “Cë” bashkë me ngritjen e vetullave (për mohim). Gjurmë të këtyre karakteristikave gjenden edhe në format më të larta kulturore, p.sh. në letërsi, në temat historike, si dhe në artin figurativ dhe pikturën letrare.

Ballkanologu i Moskës, Tatjana Civjan na ofron një model ballkanik, baza e të cilit është konvergjenca e kulturave ballkanike, e ngjashme me konvergjencën e gjuhëve, të përkufizuar nga Zandfeld, e cila u dha formë të ashtuquajturave ballkanizma, gjegjësisht gjërave të përbashkëta në strukturat gramatikore në gjuhët ballkanike që nuk i përkasin të njëjtës familje gjuhësore.

Një karakteristikë tjetër e këtij modeli, rrënja e së cilës, sipas Civjanit vjen nga koha e lashtë, është niveli i lartë i shenjave, gjegjësisht simbolikave. Me të është lidhur një botë me ide, që për këtë kohë paraqet ekskluzivitet, që ka themelet e tij në një zgjidhje të re të problemit “jetë dhe vdekje”. Jeta ishte e bazuar mbi vdekjen, gjegjësisht vdekja nuk shikohej si fundi, por si një lindje e re, si një ringjallje që do të thoshte jetë e re, më e fortë, që mund të fitohet vetëm nëpërmjet vdekjes. (Civjan, 1993: 45)

Elementet e kësaj natyre janë shumë të dukshme tek turqizmat e ndryshëm që ndodhen në terminologjinë e zanateve, kulturave të të jetuarit, emrat e pjesëve të ndryshme të veshjes dhe te ushqimi, ndërkohë që kanë origjinë osmane-turke. Në trashëgiminë e përbashkët të popujve të Ballkanit dhe në të gjithë etnoset e Maqedonisë përkasin termet, si : “para”, “jastëk”, “bojë”, “kujunxhi”, “bakër”, “jorgan”, “xhep”, “torbë”, “shallvare”, si dhe emra të disa ushqimeve, si: “sarma”, “qebap”, “qofte”, etj. Megjithatë, edhe shprehje afeksioni dhe emocioni si “budalla”, “mangup”, apo gjeste mirësjelljeje, si “bujrum”.

Në kulturën e përditshme të trashëgimisë së përbashkët të popujve të Ballkanit ky fenomen është i shfaqur në pothuajse të gjitha sferat: në arkitekturë dhe në strukturimin e qyteteve, ku gjejmë *institucionin e çajtores*, në jetën shtëpiake dhe te relacionet mes gjinive si dhe mes gjeneratave: te ushqimi, por edhe te besimet si dhe konceptet dhe sistemet e vlerës. Elemente të dalluara për sa i përket ndërtimeve janë ndërtimet unike të kohës osmane dhe gjurmët e urbanizmit osman.

Elementet ndëretnike kanë zënë vend në shumë zakone, siç është zakoni i kumbarit nëpërmjet prerjes së flokëve të fëmijës. Te myslimanët, kumbari pret pak nga flokët e fëmijës nga të katër anët e kokës, kurse te të krishterët pritet një pjesë te flokët në formë të kryqit. Te shqiptarët, të pasur kumbar lidhem me vëllazërinë sipas gjakut, shpesh herë mes myslimanëve dhe të krishterëve. Ekzistojnë disa priftërinj katolikë, të cilët me bajraktarët e tyre shkëmbejnë disa pika gjak, duke vendosur në këtë formë “vëllazëri sipas gjakut”. (Civjan, 1993: 89)

Një gjë unike për Ballkanin është lidhja e epikës popullore me një instrument muzikor të veçantë, si p.sh. lahuta. Edhe në këtë aspekt janë krijuar lidhje mbietnike. Këngëtari epik slloven apo këngëtari shqiptar paraqet një lloj kënge rrëfyese për traditat e zakonshme në një rend patriarkal, mbi personalitetet dhe ngjarjet e historisë, duke i thelluar deri në shembuj prototipikë dhe heroikë. Këto rrëfime ai i shoqëron me lahutë.

Nëpërmjet osmanlinjve, popujt ballkanas kanë zbuluar Nastradin Hoxhën, i cili gjithashtu zë një vend të veçantë në trashëgiminë popullore e ë gjithë etnive. Sa i përket kulturës muzikore, edhe ajo gjatë kësaj kohe u pasurua mjaftueshëm me anë të muzikës ushtarake turke, duke marrë tone dhe melodi lindore dhe një ngjyrim të veçantë të detajeve stilistike bashkë me instrumente të reja si daullja.

E përbashkëta e elementeve reale të jetës së përditshme dhe ndjenjës jetësore të strukturës sociale patriarkale janë manifestuar edhe në poezitë e etnive të ndryshme. Tek ato gjejmë shumë forma të përbashkëta, elemente stilistike, shenja të përbashkëta mbrojtëse në krijimin e heroikes, simbolikes dhe komikes.

## KONKLUZION

Për ne si banorë të Gadishullit Ballkanik, njëherazi dhe evropian, interesimi për historinë e përbashkët, për mentalitetet e ngjashme, për problemet e përbashkëta, për fatet e ngjashme dhe për shumë aspekte të tjera, është më se i natyrshëm. Mund lehtësisht të vihet re se për asnjë zonë të Evropës nuk është shkruar aq shumë sa për Ballkanin. Prej vitesh sintagma *Ballkani-fuçi baruti*, është konsideruar si një metaforë për një trevë plot konflikte dhe mistere, ku realja pleksej me imagjinaren. Por erdhi një ditë që ngjarjet, luftërat, realiteti i tmerrshëm ia shkarkuan ngarkesën emocionale kësaj metafore dhe e nxorën atë në dritën e vërtetë ashtu siç është, i gatshëm të ndezë zjarre, me paranoja dhe urrejtje etnike patologjike.

Për shkak të ndodhive të dy dekadave të fundit mund të konstatohet një lloj inflacioni të punimeve dhe veprave mbi Ballkanin. Në këtë gjurmim mbi Ballkanin ne u mbështetëm mbi veprat të tipit të librit *Ballkani imagjinuar* i autores bullgare Sofia Todorova në të cilin paraqet një model tjetër në trajtimin e Ballkanit dhe të konceptimit të historisë të Ballkanit, jo vetëm duke e parë me këndvështrimin e ndarjeve historike me rëndësi por sidomos, edhe në aspektin socio – psikologjik, të konstitucionit shpirtëror të banorëve të tij, të larmisë së etnive dhe religjioneve, të traditave letrare, artistike dhe kulturore.

Konfliktualiteti në vepra të këtij karakteri shihet në zanafillë, qysh në formimin e shteteve nga Fuqitë e Mëdha të kohës gjatë procesit të shpërbërjes së Perandorisë Osmane. Fuqitë e Mëdha i krijuan shtetet e Ballkanit sipas interesave të politikës të tyre të momentit. Përzier etni, u dhanë territore që nuk u takonin etnive të tjera, dhe bënë Ballkanin burim të vazhdueshëm konfliktesh pikërisht për shkak të këtyre padrejtësive. Me gjithë atë, siç konstatoam më sipër, ballkanasit kërkonin rrugët e tolerancës dhe mirëkuptimit dhe tolerancë në momente të vështira në historinë e tyre.

E megjithatë bota (sidomos Evropa dhe Amerika) u befasuan nga nacionalizmi agresiv, nga shpërthimi i dhunës dhe i luftërave barbare në ish Jugosllavi dhe kjo vinte, siç u argumentua në këtë punim sepse Evropa kishte krijuar stereotipin e vet për Ballkanin, nisur që nga Mesjeta, me kryqëzatat, kohën e romantizmit evropian, zbulimin e letërsisë antike greke, monumenteve të kulturës dhe ndikimit të madh që patën ato në zhvillimin e gjithanshëm të shoqërisë evropiane. Ballkani u bë vendi i pelegrinazhit për shumë shkrimtarë, studiues, historianë, arkeologë e të



tjerë, që me veprat e tyre krijuan një *Ballkan imagjinar*, me qytetërim oriental ku absurdja pleksej me realen, ku oksidenti përplasej me orientin.

Koha është si të gjinden modalitete efikase për mënyrën si të ndryshohet historikisht perceptimi, përgjithësisht negativ për Ballkanin që ka Evropa për të si i *paqytetëruar*. Por një nga gjërat më të bukura të kombeve ballkanike, por gjithashtu mallkimi i tyre është se kanë histori jashtëzakonisht të pasur dhe të dendur, por më së tepërmi që janë mbyllura në vetvete. Shumica e popujve ballkanikë kanë jetuar për dy mijë vite në të njëjtat perandori shumëkombëshe – Romake, Bizantine dhe Osmane.

Që pas viteve të para të dhunës ndaj rezistencës së luftës për liri, u përfshinë në jetën e perandorisë me fatin e tyre prej *popujsh të vegjël*. Ashtu dhe u siguria një matricë multikulturore dhe multietnike. Ishin gjithashtu shekuj këmbimesh, ndërmjet popujve të ndryshëm, këmbime kulturore, gjuhësore dhe njerëzore, por edhe ndeshjesh ndërmjet tyre dhe ndërmjet perandorive sa herë që shtohesh dhuna apo sa herë që shtetet feudale sulmonin njëri-tjetrin. Kjo ndodhi sidomos kur u shpërbë Bizanti, me vonë Perandoria Austro-Hungareze dhe Osmane, pra kur filluan të krijohen shtet-nacionale të dirigjuara prej interesave të forcave hegjemoniste dhe imperialiste.

Në gjurmimet tona jemi konfrontuar edhe me pyetje fundamentale mbi *ballkanizmin dhe orientalizmin*, duke kërkuar përgjigjen ose konkluzionin, a janë këto kategori të ndryshme? Derivati i termit Ballkan, domethënë *ballkanizmi* shfaqet për herë të parë pas Luftës së parë botërore, kur i caktohet kuptimi copëzimit të vendeve dhe të shteteve.

Por sipas konkluzioneve të shumë ballkanistve, shpjegimi dominant është se *iredentizmat ballkanikë nuk burojnë nga feja, por nga nacionalizmi* që sot mban pezull rajonin dhe që bota e qytetëruar duhet ta zgjidhë një herë e mirë. Vetëm kështu Ballkani plotësisht do të evropianizohet, një proces që ka nisur prej kohësh në sfera të ndryshme dhe në rajone të veçanta të tij, por që kërkon kohë të realizohet dhe pengesa më e madhe nuk janë standardet, por prapambetja ekonomike dhe izolimi nga Evropa.

Nocioni *homo balanicus* për perëndimorët është i huaj dhe ata e njohim më tepër nëpërmjet heronjve të letërsisë dhe miteve, se sa realisht. Prandaj qëndrimi ndaj Ballkanit është shumë më kompleks se tipat dhe karakteret nga literatura dhe folklori.

Është evidente që çdo ditë që kalon Ballkani po integrohet gjithnjë më shumë në Bashkimin Evropian. E kaluara evokohet për t' i shërbyer të sotmes, për të nxjerr mësim nga ajo dhe si qëllim në vetvete, pasi nuk mund të shpjegohet prapambetja e ballkanasve vetëm sepse ata kanë qenë të pushtuar nga Bizanti dhe më vonë nga Osmanët. Trashëgimia osmane pas më se një shekulli është minimizuar dhe shuar. *Që këtë del edhe konkluzioni se trashëgimitë nuk janë të përhershme por fenomene historike të kalueshme.* Fetishizmi i tyre është propagandë vulgare ideologjike për të justifikuar prapambetjen.

Kur flitet për prapambetje të popujve të Ballkanit, mund të thuhet në *konkluzion, se duhet të kuptohet si një dukuri relative që po zhduket me kohë dhe punë, si pasojë e procesit dialektik.* Kështu nuk duhet harruar se gjatë historisë ka pasur edhe shekuj të errët për Evropën Perëndimore (inkuizicionet, likuidimet masive, llogoret e vdekjes, holokausti), me dukuri dhe më negative se ato që u vërejtën në vendet ballkanike në shekullin e kaluar.

Ajo që vlen të theksohet në konkluzion është fakti pozitiv i dëshirës për përparim dhe integrim në familjen evropiane. Por pranimi në Evropë nuk është i mundur me bagazhin dhe kortezhin e miteve të së shkuarës dhe me dëshirën për të sunduar popuj të tjerë, duke bartur tek të tjerët kriza dhe pengesa për zhvillimin e të gjithëve.

Sot gjërat vazhdojnë të jenë në tranzicion. Nga Samiti i Bukureshtit kur Greqia dha “jo”-në e saj të parë edhe pse në atë kohë edhe Shtetet e Bashkuara ishin të vendosura që të pranonin integrimin e Maqedonisë në Bashkimin Evropian, ka nisur një udhëtimi i vështirë plot reforma dhe kriza. Shtetet e Ballkanit nuk tentojnë të provojnë mënyra alternative të integritit në Bashkimin Evropian, në formën e partneriteteve apo në atë të fqinjësisë. Struktura e tyre heterogjene nuk lejon një kompromis të tillë të vakët politik. Këtyre shteteve dhe de facto kulturës që lind dhe zhvillohet brenda tyre u nevojitet një strukturë politiko-sociale me një standard i cili do t' i nxjerrë nga niveli i mbijetesës dhe mjerimi ekonomik.

Me afrimin me NATO-n sigurisht, gjërat do të jenë më të sigurta dhe ky është një hap i mirë për shtetin tonë. Pa të, nuk do të mund të aspironim për arritje më të larta në sferën e kulturës apo zhvillimit socio-politik që ofron Bashkimi Evropian. Por përpjekja nuk ka reshtur, pavarësisht refuzimeve dhe përpjekjeve për t' u kategorizuar në të ashtuquajrën “zonë ekonomike”.

Arsyet se pse ndonjë shtet do të vendoste të ishte pro apo kundër integrimit në Bashkimin Evropian janë të ndryshme dhe të kushtëzuara nga zhvillimi i secilit. Andaj nuk mund të krahasohet nevoja dhe dëshira e Britanisë së madhe për të dalë nga BE me arsyet e shteteve kandidate të cilat presin që integrimi të jetë një shkallare e lartë pas ngjitjes së cilës ata do të mund të përjetojnë më në fund një mirëqenie.

Një rivlerësim i kulturës mund të na bëjë shumë më të vetëdijshëm edhe mbi rastet e veçanta të fqinjve tanë, si për shembull rasti i Kosovës. Konflikti i tanishëm brenda shtetit të Kosovës mund të sjellë një pasojë të cilën ky shtet i ri nuk do të mund ta përballojë. Por na takon ne, si bashkëvujtës të një rajoni, të një kombi madje, apo të një feje dhe një tradite të madhe ballkanike, të mbështesim dhe të luftojmë që asnjërin nga fqinjtë tanë të mos e kapojë një krizë e thellë ideologjike dhe përçarëse. Pasi një krizë e një shteti ndikon domodoshmërisht mbi shtetet fqinje.

Pra, kultura me pak fjalë, na thërret drejt një rikonsiderimi vlerash dhe parimesh, një mënyrë të re për të parë historinë dhe të ardhmen dhe për të mësuar se jemi protagonistë dhe nevojitet që veçse të kritikojmë, të mësojmë të gjucojmë duke u bazuar te ajo që vetë shohim dhe ndjejmë si të vërtetë. Edhe nëse shtetit tonë apo cilit do nga shtetet ballkanike, do t'i duhej të kalonte në procesin e reversibilitetit, kjo nuk do të duhet të frikësonte Ballkanin. Pasi një rishqyrtim vlerash nevojitet në çdo vend ku ekziston një heterogjeni kaq e madhe dhe një paqëndrueshmëri e synimeve strategjiko-politike.

Reformat në administratën publike, gjykatë, politikë, media dhe kulturë janë të domosdoshme dhe ndryshimi i mentalitetit diktatorial ku qeveria apo opozita janë ata që përcaktojnë vlerat reale të një populli. Qeveria dhe opozita nuk janë veçse aktorë politikë të cilët duhet t'i shërbejnë kulturës dhe jo ta formojnë apo ta shkatërrojnë atë.

Mbi të gjitha, Bashkimi Evropian na thërret drejt një shqyrtimi vlerash kulturore duke e vënë në piadestal: diskutimin, transparencën, saktësinë dhe zbatimin e ligjit. Me afrimin drejt NATO-s tashmë kultura jonë ka marrë një kahje pastrimi nga disa vese dhe tendenca vulgariteti dhe manipulimi me ligjin, gjë që duhet parë si një kontribut i çdo anëtarësimi në një strukturë të mirëetabluar në të ardhmen.

## **BIBLIOGRAFIA**

Bernard Adam, *La guerre de Kosovo*, Paris 1999.

Bernard Lory, Cristophe Chiclet , *Las République de Macédoine- Nouvelle venu dans le concert européen*, Harmatan, Paris, 1998.

Cantacuzène, Jean-Michel, *Milles ans dans les Balkans*, Paris, 1999.

Castellan, Georges, *Histoire des Balkans, XIV-XIX s.* Fayard, Paris 1991.

Castellan, Georges, *Histoire des Balkans: XIVE-XXe siècles*, Paris: Fayrad, 1991.

Cvijic, Cristopher, *Remaking the Balkans*, London: Royal Institute of International Affairs, 1991.

Cvijic, Jovan, *La péninsule balkanique: géographie humaine*, Paris: A. Colin, 1918.

Çabej, Eqrem *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit*, Tiranë, 1994.

Domenique, Moisi, , *Gjeopolitika e emocioneve*, Instituti i studimeve Ndërkombëtare, Tiranë, 2012.

Durand, D, *Les structures anthropologiques de l' imaginaire*, Paris, Flammarion, 1992.

Durham ,Edith, *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe Shqiptarët*, „8 Nëntori”, Tiranë, 1990.

Durham, Edith *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për shqiptarët*, Tiranë ,1990.

Durham, Edith, *Some tribal origins, laws and customs of the Balkan*, London, 1928.

Elsie, Robert, *Historical Dictionary of Albania*, London, 2010.

Foucher, Michel, *La République européenne , entre histoire et géographie*, Paris, Berlin, 1999

Friedman, Victor A. *Studies on Albanian and Other Balkan Language*, 2004.

Friedman, Victor A., *Mbi konceptet nacionale në fjalorin tri gjuhë e Gjorgji Pulevskit*, Akademia e shkencave dhe e arteve të Kosovës, 1997.

Friedman, Victor A., *Le multilinguisme en République de Macédoine et l' union balkanique aujourd' hui*, Paris: Association Pierre Balon. 2011.

Friedman, Victor A.,,Balkan Linguistics and and the Challenge of EU Integration:Minorites and Majorites, Cambrige Scholars Publishing, 2008.362-375.

Fuga, Artan. L'Albanie entre la pensée totalitaire et la raison fragmentaire, Harmatan, Paris,1999.

Garde, Paul, Vie et morta de la Yougoslavie,Fayard, 1992, 444 p.

Garde, Paule, Les Balkans, Héritage et évolution, Paris, 2010.

Gellner,Ernest,Nations et nationalisme,Payot, Paris, 1999.

Hayden, Robert M.,,„Antagonistic Tolerance”,in Curent Antropology, 43 (2002):205- 231.

Huntington, Samuel *The Clash of Civilisations and the Remaking of dhe New World Order*, New York, 1996.

Huntington, Samuel, *The Clash of Civilization*, Simon&Shuster, New York,1996.

Jacques, Ancel, *Peuples et nations des Balkans*, Paris: A. Colin, 1930.

Jalvich, Barbara, *History of the Balkan*, 1983.

Janusz Bugajski,*Balkans in dependence?*, The Washington Quaterly, Washington, 2000.

Kadare, Ismail, *Identiteti i shqiptarëve*, „Onufri”, Tiranë,2006.

Kadare, Ismail, Predrag Simic, Ljubomir Frckoski, Ylber Hysa, *Ballkani i jugut*, Onufri, Tiranë,2005.

Kadare, Ismail, *The Three-Arched Bridge*, Franklin, N.Y.: New Amsterdam, 1995.

Kadare,Ismail, *Poshtërimi në Ballkan*, Onufri, Tiranë 2004.

Kitsikis, Dimitri, *La Montée du national-bbolhevisme dans les Balkans*, Paris, 2008.

Kitsikis, Dimitri. *La montée dr national-bolchevisme dans les Balkans* , Paris, 2008.

Kovac, Nikola, *Bosnie, le prix de la paix*, Mishalon, Paris, 1995, 170 p.

Kristeva,Julia ,”Boulgarie ma souffrance’’, L’Infini, 51, Paris, 1995.

Kullashi, Muhamedin *Përplasja e identiteve*, Dukagjini, Pejë, 2003.

Kullashi, Muhamedin,, Humanisme et haine, Les intellectuels et le nationalisme en ex-Yougoslavie, Paris, 1998.

Lazarevic Radak, Sanja ,,Na granici Orijenta i Okkcidenta postkolonijalna teorija I liminalnost Balkana “(<http://teme.junis.ni.ac.rs/teme4-2022/teme%204-2011-15PDF>)

Lévi ,Bernard – Henri, La pureté dangereuse, Paris, Grasset,1994, 303 p.

Lionel ,L'éclatement yougoslave.Une tragédie européenne, La Tour-Aigues, 1994.

Maspero, François. Balkans-transit, Seuil, Paris, 1996.

Matran, Rober, l'Histoire de l'Empire ottoman, 1989, Fayard, Paris, 810 p.

Matvejevitch, Predrag, Entre asile et exil, Stock, Pais,1995.P

Minc, Alain La vengeance des nations, Paris, 1990.

Mircea, Eliade, The Myth of the Eternel Reyrn, (Princeton University Press), New York ,1974.

Morin, Edgar Les fratricides (Yougoslavie-Bosnie 1991-1995), Paris, 1996.

Morin, Edgar, Les, Les fratricides,Paris, Arlea, 1995.

Muggeridge, Malcom, Mère Teresa de Kalkuta, Seuil, Paris, 1998

Nicolae, Iorga, *Histoire des Etats balkaniques jusqu'à 1924*, Paris: J. Gamber, 1924.

Nouzille, Jeantoire de frontières, Berg, International editions, 1992.

Ossevarde, Marinus, Ismail Kadare' s Idea of Europe, University of Tvente,2015.

Owen, David *Balkan Odyssey*, Viktor Gollancz,London . 1995.

Philips, David L., *Steps to Stabilize dhe South Balkans*, The Wall Street Journal Evrope, 3-4 november 2000.

Plasari, Aruel *Rrëmbimi i Evropës*, Tri Ese, Tiranë, 2005.

Potel, Jean-Yves, les 100 portes de l' Europe Centrale et Orientale, L' Atelier, 1998.

Prévélakis, Georges Les Balkans : culture et géopolitique, Paris, 1994.

Qosja, Rexhep, *La question albanaise*, Fayard, Paris, 1995.

Reed, John *La Guerre dans les Balkans*, trad. de l'américain par F. Maspero, Paris, 1996.

Ricœur, Paul, *La mémoire, l'histoire, l'oubli*, Paris, Seil, 2000.

Ristelhuber, René, *Histoire des peuples balkaniques*, Paris, Fayard, 1950, 503 page.

Rugova, Ibrahim, *La question du Kosova*, Fayard, 1994.

Rupnik, J, *Les Balkans Paysage après la bataille*, Complexe, Bruxelles, 1998, 170 p.

Said, Eduard *Orientalizmi: Koncepte Perëdimore për Orientin*, Logos A, Shkup.

Said, Edward W., *Culture and Imperialism*, London: Chatto and Windus, 1992.

Said, Edward, "East isn't East," *Times Literary Supplement*, 3 February 1995, 3-6.

Said, Edward, *Orientalism*, New York: Pantheon, 1978.

Samir, Amin, *Eurocentrism*, New York: Monthly Review Press, 1989.

Samovar, L.A – Potter R.E., *Communication Between Cultures*, Belmont, CA, Wadsworth, 1991.

Sivignon, Michel, *Les Balkans: une géopolitique de la violence*, Paris-Berlin, 2009.

Sloane, William Milligan, *The Balkans: A Laboratory of History*, Miami, Florida, 2013.

Stark, Hans, *Les Balkans, Le retour de la guerres en Europe*, IFRI, Paris 1993.

Stipiceviq, A., *simbolizmi ilir e simbolizëm shqiptar*, Studime historike, Tiranë, IH-ASH, 1973, nr.2 f129- 134.

Sulejmani, Fatmir. *Faik Konica-eseist*, Brezi, Tetovë, 2007.

Sulstarova, Enis *Arratisje nga lindja- Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*, Tiranë, 2009

Sulstarova, Enis, *Arratisja nga lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*, Tiranë, 2013.

Todorov, Cvetan, *Mi i drugi: francuska misao o ljudskoj raznolikosti*, Beograd, Biblioteka XX vek

Todorov, Cvetan, *La peur des barbares: au-delà du choc des civilisations*, Paris, Robert Laffont, 2008.

Todorova, Maria *Imagining Balkan*, New York Oxford University, 1997.

Todorova, Maria, *Imagining the Balkans*, New York: Oxford University Press, 1997.

Toodorov, Cvetan, *Le abus de la mémoire*, Paris, Arléa, 1995.

Trita, Mark, *Mitologjia ndër Shqiptar*, Akademia e shkencave et Shqipërisë, Instituti i kulturës popullore, dega e Etnologjisë, Tiranë, 2004.

Vernet, Daniel et Jean Marc Gonin, *Le rêve sacrifié*, Odil Jacob, Paris, 1994.

Webel, Ernest, *Histoire et géopolitique des Balkans de 1900 à nos jours*, Paris, 2002.

Weibel, Ernest. *Histoire géopolitique de 1900 à nos jours*, Paris 2002.

Woodward, Susan L.: *Balkan tragedy: Chaos and Dissolution after the Cold War*, ,, The Brooking Institution, Washington, 1995.

Xholi, Zija, *Mendimtarë të Rilindjes Kombëtare*, Tiranë, 1987.